



20
23

RAPORT
VJETOR



Adresa: Rruga "Skerdilajd Llagami", Nd.1, H.6, Tiranë.
Tel:+355 (0) 42251001, www.aida.gov.al | e-mail: info@aida.gov.al

RAPORTI VJETOR 2023

1

Profili i AIDA-s

2

AIDA në ushtrim të funksioneve të veta

3

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

4

Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë

5

Drejtoria e Koordinimit

6

Drejtoria e Shërbimeve Mështetëse

1 PROFILI I AIDA-S

1.1 Misioni

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ka për mision të rrisë konkurrueshmërinë e sektorit privat, të forcojë potencialin eksportues të vendit, të promovojë mbështetjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta në Shqipëri, si dhe të promovojë potencialin turistik të vendit. AIDA, maksimizon investimet e brendshme dhe të huaja, nëpërmjet krijimit të iniciativave ndihmuese rrit aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve në Shqipëri, përmirëson kapacitetet teknologjike dhe rinovimin e tyre me qëllimet e kombinuara që të rris investimet e huaja direkte, të forcojë kapacitetet e biznesit shqiptar, si edhe të ndërtojë një imazh të denjë të Shqipërisë me fokus tërheqjen e investitorëve të ndryshëm.

1.2 Funksionet kryesore të AIDA-s

Veprimtaria e Agjencisë përqëndrohet, kryesisht, në:

- Lehtësimin dhe mbështetjen e investimeve të drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë;
- Rritjen e aftësisë konkurruese dhe inovative të ndërmarrjeve të vogla e të mesme;
- Nxitjen dhe ndihmën ndaj eksporteve të mallrave e të shërbimeve;
- Nxitjen dhe tërheqjen e investimeve strategjike, vendase dhe të huaja.

Agjencia ndërmerr të gjitha nismat e nevojshme në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat dhe të përmirësimit të klimës së biznesit, duke ndjekur dhe duke ndihmuar subjektet tregtare private në të gjitha fazat e veprimtarisë së tyre ekonomike, si edhe duke ndërmjetësuar e duke bashkëpunuar me investitorët e organet shtetërore.

1.3 Kuadri ligjor i Agjencisë

AIDA funksionon në bazë të kuadrit ligjor të posaçëm:

- Ligjit nr. 10 303, datë 15.7.2010 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”,
- Statutit të AIDA-s, miratuar me Vendim të Bordit Drejtues të AIDA-s nr. 2, datë 04.01.2011, të ndryshuar me vendimin nr. 1, datë 25.03.2019,
- Rregullores së Brendshme të AIDA-s, miratuar me vendimin e Bordit Drejtues të AIDA-s nr. 11, datë 21.07.2011;
- Vendimit nr. 3, datë 17.06.2019 “Për miratimin e nivelit të pagave dhe të strukturës e organikës së Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

Aktualisht, AIDA strukturohet në pesë drejtori:



1.4 Organigrama



Drejtoria e Investimeve ka këto funksione:

Objektivi i Drejtorisë së Investimeve është zbatimi i politikave të Qeverisë Shqiptare në lidhje me mbështetjen e investimeve, hartimin dhe propozimin e masave mbështetëse që synojnë realizimin e suksesshëm të politikave për promovimin e investimeve.

- Asiston dhe mbështet investimet e drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet identifikimit e promovimit të mundësive për investime;
- Ofron shërbimin e përkujdesjes dhe mbështetjes së investitorëve ekzistues ose potencialë;
- Asiston dhe mbështet me procedura të përshpejtuara investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë.

Drejtoria e NVM dhe Projekte ka këto funksione:

Objektivi i Drejtorisë NVM dhe Projekteve është të ofrojë shërbime për mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, (NVM) shqiptare nëpërmjet asistencës teknike, promovimit të bizneseve shqiptare në tregjet ndërkombëtare, si dhe krijimin e lidhjeve dhe mundësive të bashkëpunimit me bizneset e huaja. Drejtoria ndihmon Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme në shfrytëzimin e financimeve publike, kombëtare dhe ndërkombëtare.

- Të rrisë aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme shqiptare për zhvillimin e tyre;
- Mbështetja e sipërmarrësve shqiptarë dhe partnerëve të huaj që dëshirojnë të hyjnë në partneritet me kompani shqiptare nëpërmjet shërbimeve kryesore, si:

dhënia e granteve të shtetit shqiptar apo identifikimi i tregjeve ose partnerëve të rinj për eksport, nevojat për trajnim dhe për certifikim produkti, lehtësimin e pjesëmarrjes në panaire ndërkombëtare, mbështetje nëpërmjet projekteve të ndryshme me donatorë.

c) Promovimi i produkteve dhe shërbimeve shqiptare në tregjet ndërkombëtare, për të reklamuar dhe për të lehtësuar eksportin e produkteve “Made in Albania”.

Drejtoria e Koordinimit ka këto funksione:

Objektivi i Drejtorisë së Koordinimit është mbajtja dhe koordinimi i ndërveprimit me institucione dhe organizma brenda dhe jashtë vendit, duke bashkërenduar punën me drejtoritë e AIDA-s, si dhe matja e vlerësimi i rezultateve të performancës së institucionit me qëllim orientimin e politikave.

- Mbajtjen dhe koordinimin e marrëdhënieve institucionale me institucione dhe organizma brenda dhe jashtë vendit, duke bashkëpunuar me departamentet brenda AIDA-s;
- Matjen dhe vlerësimin e rezultateve të performancës së institucionit me qëllim orientimin e politikave dhe burimeve.

Drejtoria Marketing & Kërkim Analizë ka këto funksione:

Objektivi i Drejtorisë Marketing dhe Kërkim Analizë është zhvillimi dhe përgatitja e marketingut dhe e shërbimeve të nevojshme në mbështetje të drejtorive të tjera të Agjencisë.

Drejtoria siguron informacione mbi tregun dhe strategjitë e reja, kryen studime tregu dhe kërkim të dhënash, me qëllim përditësimin e materialeve dhe informacioneve, në funksion të drejtorive dhe investitorëve.

- Sigurimin e komunikimit dhe marketingut të institucionit për politikat, prioritetet, aktivitetet, fushatat etj.;
- Kërkim dhe analizën në lidhje me variabla të ndryshme që AIDA i ka në fokus t'i mbulojë në përmbushje të ligjit të saj organik.
- Promovimi i Shqipërisë në komunitetin e investitorëve dhe prezantimi i mundësive për investim, pranë investitorëve potencialë apo ekzistues.

2 AIDA NË USHTRIM TË FUNKSIONEVE TË VETA

2.1 Hyrje

AIDA, ju ndihmon të investoni në Shqipëri duke ju mbështetur me:

Informacione mbi mundësitë e investimit në Shqipëri dhe arsyt kryesore përse vendi ynë është tërheqës për Investimet e Huaja Direkte. Të gjithë informacionin rreth ekonomisë së Shqipërisë, burimet njerëzore, infrastrukturës, stimujve investues prezantohen në një shkallë të gjerë me dokumente në shqip dhe anglisht.

Kontakte nga Shqipëria apo jashtë saj, falë një pune paraprake anketimi dhe misioneve specifike të kontaktit për të përmbushur nevojat e investitorëve. Qasja jonë është të paraqesim ofertën më të kënaqshme shqiptare për kompanitë që kërkojnë ndërkombëtarizim.

Këshilla për mjedisin e përshtatshëm për suksesin e projekteve, rajoneve të funksionimit, planeve të investimeve dhe metodave të financimit.

Ndihmë për investitorët me vizitat eksploruese në Shqipëri dhe në fazat e ndryshme të zbatimit të projektit. Programet e kontaktit me institucionet dhe kompanitë shqiptare në fushat e aktiviteteve të dëshiruara dhe interesave të investitorëve, të cilat përgatiten nga stafi i AIDA-s.

Mbështetje për të përmirësuar qëndrueshmërinë e kompanisë përmes monitorimit të personalizuar dhe ndihmës së vazhdueshme me departamentet e ndryshme ministrore shqiptare, si dhe me organizatat dhe autoritetet rajonale.

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetës ka këto funksione:

Objektivi i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse është garantimi i mbarëvajtjes administrative, teknike, ligjore dhe financiare për funksionimin normal të institucionit, në bashkëpunim me njësitë e krijuara sipas legjislacionit përkatës.

a) Mbështetja e veprimtarisë së Agjencisë, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, me qëllim krijimin e infrastrukturës dhe burimet e domosdoshme që garantojnë zhvillimin e veprimtarisë normale të proceseve të punës.

b) Ndjekja e aktivitetit ekonomiko-financiar dhe administrativ të institucionit, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2.2 Investimet

2.2.1. Investimet e huaja direkte në Shqipëri (IHD)

Referuar të dhënave nga Banka e Shqipërisë, trendi i IHD-ve në terma të fluksit, vijon si më poshtë:

VITI	2018	2019	2020	2021	2022	2023
FLUKSI (mln EURO)	1020	1073	937	1035	1372	1492

Burimi: Banka e Shqipërisë, përpunuar nga autori

Për vitin **2023**, indikatorin e fluksit shënon vlerën rreth **€ 1.5 miliardë**, duke shënuar shifër rekord në fluksin e investimeve të huaja direkte në vend. Krahasuar me vitin 2022, treguesi i fluksit ka pësuar **një rritje me € 120 milionë** ose me **8.7%**.

2.2.1.2. Fluksi dhe stoku i IHD-ve sipas shteteve

- Fluksi sipas shteteve

Për vitin **2023**, fluksi i investimeve të huaja në vend është dominuar nga **Hollanda** e cila ka kontribuar me rreth **20%** në fluksin total, e ndjekur nga **Italia** me **13.6%**, **Turqia** me **12%**, **Austria** me **8%** dhe **Kosova** me **4.9%**.

SHTETI	VLERA E FLUKSIT 2023 (mln EURO)
Hollandë	300
Itali	203
Turqi	179
Austri	119
Kosovë	73
SHBA	62
Francë	60
Gjermani	59
Bullgari	29
Zvicër	27

Burimi: Banka e Shqipërisë, përpunuar nga autori

- Stoku sipas shteteve

Në fund të vitit **2023**, stoku i investimeve të huaja në vend është dominuar nga **Hollanda** e cila ka kontribuar me rreth **16.8 %** në stokun total, e ndjekur nga **Zvicra** me **15.7%**, **Kanadaja** me **12.6%**, **Italia** me **11%** dhe **Turqia** me **7.7%**.

Më poshtë gjendet tabela me vlerat përkatëse të stokut për 2023 sipas shteteve kryesore:

SHTETI	VLERA E STOKUT 2023 (mln EURO)
Hollandë	2235
Zvicër	2088
Kanada	1677
Itali	1476
Turqi	1026
Bullgari	814
Austri	799
Francë	489
Gjermani	394
Hungari	333

Burimi: Banka e Shqipërisë, përpunuar nga autori

2.2.1.3 Fluksi dhe stoku i IHD-ve sipas aktivitetit ekonomik për vitin 2023

- Fluksi sipas aktivitetit ekonomik

Për vitin **2023**, burimi kryesor i hyrjeve të IHD-ve në terma të fluksit ishte sektori i **Aktiviteve të pasurive të paluajtshme** që përfaqësonte rreth **19.5%** të fluksit total.

Sektorë të tjerë ekonomik me një kontribut të lartë janë sektori i **Industrisë nxjerrëse** me **18%**, i **Aktiviteve financiare dhe të sigurimit** me **16%**, i **Energjisë elektrike, gazit, dhe furnizimit me ujë** me **10.6%**, i **Tregtisë me shumicë dhe pakicë** me **8.4%** dhe ai i **Industrisë përpunuese** me **8.3%** ndaj totalit

Më poshtë gjendet tabela me vlerat përkatëse të fluksit për 2023 sipas aktiviteve ekonomike kryesore:

AKTIVITETI EKONOMIK	VLERA E STOKUT 2022 (mln EURO)
Aktivite të pasurive të paluajtshme	291
Industria nxjerrëse	270
Energjia elektrike, gazi, dhe furnizimi me ujë	159
Aktivite financiare dhe sigurimit	239
Tregtia me shumicë dhe pakicë	125
Industria përpunuese	124

Burimi: Banka e Shqipërisë, përpunuar nga autori

- Stoku sipas aktivitetit ekonomik

Në fund të vitit 2023, burimi kryesor i hyrjeve të IHD-ve në terma të stokut ishte Energjia elektrike, gazi, dhe furnizimi me ajër të kondicionuar që përfaqësonte **25% të stokut total**.

Sektorë të tjerë ekonomik me një kontribut të lartë janë sektori i **Industrisë nxjerrëse** me **16.4%**, **Aktiviteve financiare dhe të sigurimit** me **11.7%**, i **Aktiviteve të pasurive të paluajtshme** me **11.7%**, i **Informacionit dhe Komunikacionit** me **10.2%** dhe i **Industrisë përpunuese** me **8.9%** ndaj totalit.

Më poshtë gjendet tabela me vlerat përkatëse të stokut për 2023 sipas aktiviteve ekonomike kryesore:

AKTIVITETI EKONOMIK	VLERA E STOKUT 2022 (mln EURO)
Energjia elektrike, gazi, dhe furnizimi me ujë	3,320
Industria nxjerrëse	2,186
Aktivite financiare dhe sigurimit	1,564
Aktivite të pasurive të paluajtshme	1,563
Informacioni dhe komunikacioni	1,366
Industria përpunuese	1,189

Burimi: Banka e Shqipërisë, përpunuar nga autori

2.3. TREGTIA E JASHTME

2.3.1. Të dhënat mbi importet

Importet për vitin 2023 shënojnë vlerën e afro 8.4 miliardë EURO, me një rënie prej 8.1% nga viti paraardhës. I njëjti tregues, për vitin 2022, arrin vlerën e afro 9.1 miliardë EURO.

Peshën më të madhe në këtë indikator për vitin 2023 e përbën grupmali 'Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi' me 24.4% ndaj totalit, i ndjekur nga grupmali 'Ushqim, pije, duhan' me 16.7% si edhe nga 'Materiale ndërtimi dhe metale' me 14%.

Lidhur me përbërjen e strukturës së importeve në 2022, peshën kryesore e ka pasur grupmali 'Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi' me 19.6% ndaj totalit, i ndjekur nga grupmali 'Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike' me 18% si edhe nga 'Ushqim, pije, duhan' me 15.7%.

GRUPMALLI	Janar - Dhjetor 2023 (mln EURO)	Janar - Dhjetor 2022 (mln EURO)
Ushqim, pije, duhan	1402	1435
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	980	1650
Produkte kimike dhe plastike	1097	1126
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	131	1674

Prodhime druri dhe letre	289	339
Tekstile dhe këpucë	906	979
Materiale ndërtimi dhe metale	1181	1318
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	2048	1798
Të tjera	358	330
TOTALI	8391	9138

Burimi: INSTAT, përpunuar nga autori

Sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT për vitin 2023, shtetet prej të cilave Shqipëria ka importuar më së shumti, janë si më poshtë vijon:

SHTETI	Vlera (mln EURO)	% ndaj totalit
Itali	1980	23.6
Turqi	1102	13.1
Kinë	745	8.9
Greqi	716	8.5
Gjermani	563	6.7

Burimi: INSTAT, përpunuar nga autori

Italia zë peshën kryesore me 23.6% ndaj totalit duke u kthyer në një shtet dominant për importet e vendit tonë. Shtete të tjera me ndikim të lartë në këtë indikator janë Turqia, Kina, Greqia dhe Gjermania.

2.3.2. Të dhëna mbi eksportet

Eksportet për vitin 2023 shënojnë vlerën e afro 4.2 miliardë EURO, me një rënie prej 9.5% nga viti paraardhës. I njëjti tregues, për vitin 2022, arrin vlerën e afro 4.7 miliardë Euro.

Peshën më të madhe në këtë indikator për vitin 2023 e përbën grupmali 'Tekstile dhe këpucë' me 28.6% ndaj totalit, i ndjekur nga grupmali 'Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike' dhe 'Materiale ndërtimi dhe metale' me 21.3% dhe 18.9% respektivisht.

Lidhur me përbërjen e strukturës së eksporteve, në vitin 2022 peshën kryesore e ka pasur po grupmali 'Tekstile dhe këpucë' me 27.7% ndaj totalit. Më pas renditej grupmali 'Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike' me 22% dhe 'Materiale ndërtimi dhe metale' me 21.6%.

GRUPMALLI	Janar - Dhjetor 2023 (mln EURO)	Janar - Dhjetor 2022 (mln EURO)
Ushqim, pije, duhan	535	497
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	904	1034
Produkte kimike dhe plastike	157	169
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	25	28
Prodhime druri dhe letre	107	137
Tekstile dhe këpucë	1214	1300
Materiale ndërtimi dhe metale	800	1013
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	376	382
Të tjera	114	120
TOTALI	4234	4681

Burimi: INSTAT, përpunuar nga autori

Sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT për vitin 2023, shtetet në të cilat Shqipëria ka eksportuar më së shumti, janë si më poshtë vijon:

SHTETI	Vlera (mln EURO)	% ndaj totalit
Itali	1817	42.9
Kosovë	393	9.2
Gjermani	222	5.1
Greqi	276	6.5
Spanjë	182	4.2

Burimi: INSTAT, përpunuar nga autori


Italia zë peshën kryesore me 42.9% ndaj totalit të eksporteve duke u kthyer në një shtet dominant edhe në eksportet e vendit tonë. Shtete të tjera me ndikim të lartë në këtë indikator janë Kosova, Greqia, Gjermania dhe Spanja.


2.4. TREGU I PUNËS

2.4.1. Indikatorë të Tregut të Punës

Forca e punës gjatë periudhës 2017-2019 ka qenë në rritje, ndërsa në 2020 ka paraqitur një rënie të lehtë e ndjerë nga efektet e pandemisë, të cilat vazhduan të ishin të pranishme dhe për vitin 2021.

Gjatë vitit 2022, numri i të punësuarve në Shqipëri është **1.298.380 persona**. Krahasuar me vitin parardhës, ky numër u rrit me **3,97 %**. Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për popullsinë 15-64 vjeç është **73,2 %**.






Burimi: INSTAT, përpunuar nga autori

2.4.2 Shkalla e papunësisë

Gjatë vitit 2022, numri i të papunëve në Shqipëri është **159.579 persona**. Shkalla zyrtare e papunësisë është **10,9 %** dhe u ul me **0,6 pikë** përqindje krahasuar me vitin 2021. Shkalla zyrtare e papunësisë për meshkujt është **10,6 %** dhe për femrat është **11,4 %**. Shkalla e papunësisë për grupmoshën **15-24 vjeç** është **24,9 %**. Krahasuar me vitin paraardhës, shkalla e papunësisë për këtë grupmoshë pësoi një zbritje prej **2,2 pikë** përqindje.

Papunësia sipas grup moshave, 2021-2022




Burimi: INSTAT, përpunuar nga autori

2.4.3 Punësimi sipas statusit në punësim

Për vitin 2022, rezulton se **47 %** e të punësuarve janë të punësuar me pagë, **31.5 %** janë të vetë-punësuar (punëdhënës ose të vetëpunësuar pa të punësuar të tjerë) dhe **21.5 %** janë punëtorë pa pagesë në biznesin e familjes. Niveli i të punësuarve me pagë ka ndryshuar me **6.3%** krahasuar me vitin 2017.

Punësimi sipas statusit në punësim (në %)



Burimi: INSTAT, përpunuar nga autori

2.4.4. Paga minimale

Paga minimale është nga ata indikatorë të tregut të punës me dy impakte direkte: është indikator që tërheq interesin e investitorëve të huaj, por njëkohësisht përcakton edhe standartin e investimit potencial të huaj.

	2018	2019	2020	2021	2022	2023
PAGA MINIMALE	24000	26000	26000	32000	34000	40000

Burimi: INSTAT, përpunuar nga autori

2.4.5. Paga mesatare

Në vitin 2022, paga mesatare bruto për një të punësuar me pagë në Shqipëri është 61,898 lekë. Krahasuar me vitin 2021, paga mesatare mujore bruto për një të punësuar në Shqipëri u rrit me 8,23 %. Gjatë vitit 2022, 26,8 % e kontribuesve në kategorinë e të punësuarve me pagë marrin një pagë mesatare mujore bruto deri në nivelin e pagës minimale zyrtare.

	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Paga mesatare mujore bruto	48967	50589	52380	53662	57191	61898
Paga mesatare mujore në sektorin shtetëror	59813	61023	63084	64330	68508	70007
Paga mesatare mujore në sektorin privat	44027	45759	47532	48620	51858	58211

Burimi: INSTAT, përpunuar nga autori

2.5. LEAD GENERATION & AFTERCARE

2.5.1. Gjenerimi i Leads, ndjekja dhe follow-up i tyre

AIDA vazhdimisht asiston kompanitë e interesuara duke u mundësuar informacion të përditësuar mbi klimën e biznesit në Shqipëri, sistemin e taksave, lehtësirat që ofrohen për investitorët e huaj, kuadrin ligjor për investimet, mundësitë për partneritete me biznese vendase, etj.

Gjatë vitit 2023, AIDA ndoqi 4 “Leads” të rinj, të cilët së bashku arrijnë një vlerë investimi prej 128 Milionë Euro.

Lead me zhvillimet më të mëdha ka qenë ai i kompanisë Visccher-Caravelle, kompani gjermane e cila synon hapjen e një fabrike në sektorin automotiv me një vlerë investimi rreth 20 Milionë Euro, kompani e cila u asistua nga AIDA dhe për realizimin e vizitave në terren në lokacione specifike.

2.5.2 Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027

Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 (BIDS), është një dokument ligjor me rëndësi të veçantë për zhvillimin e biznesit dhe investimeve, duke e konsideruar adresimin e duhur të tyre si kusht drejt një zhvillimi të qëndrueshëm. Kjo strategji përbën orientimin kryesor të Qeverisë Shqiptare për zhvillimin ekonomik afat-mesëm, duke u fokusuar kryesisht në zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme si edhe investimet.

AIDA është një aktor i rëndësishëm në implementimin në praktikë të BIDS dhe praktikave të parashikuara nga strategjia. Në tërësinë e saj “BIDS 2021 – 2027” përbëhet nga një qëllim strategjik kryesor që është “Zhvillimi plotësisht i potencialeve të investimeve për zhvillimin ekonomik dhe nxitjen e integritimit në tregjet ndërkombëtare dhe zinxhirët e vlerës”. Në këtë qëllim strategjik zenë vend po ashtu edhe objektiva specifike që reflektojnë nevojën për ndryshim apo shtimin e dimensioneve të reja drejt të cilave duhet të fokusohet vëmendja për adresimin e duhur të çështjeve të zhvillimit të biznesit dhe investimeve të huaja, bazuar dhe në zhvillimet më të fundit, si dhe duke konsideruar çështje të lidhura me pandeminë e COVID-19 apo fushat e reja deri tani të paadresuara apo shumë pak të adresuara në lidhje me biznesin (ndryshimet teknologjike, digjitalizimi, etj).

Në përmbushje të vizionit të BIDS 2021-2027 institucionet shtetërore që kanë përgjegjësi në këtë fushë, në partneritet me institucione dhe organizata të tjera do të fokusohen në tërheqjen e investimeve dhe ndërkombëtarizimin përmes masave përkatëse:

- **Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi**

Strategjia e re vendos theksin mbi rëndësinë strategjike të investimeve dhe integritimit në zinxhirin e vlerave dhe tregjet ndërkombëtare për rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm si dhe shpалosjen e plotë të potencialit investues për zhvillim ekonomik.

Masat:

1. Promovimi /lehtësimi sistematik i investimeve të synuara. Në kuadrin e BIDS, AIDA, përgjatë vitit 2022 realizoi fushatën e parë Outreach Campaign në sektorin e bujqësisë në Stamboll, Turqi. Fushata u realizua në përputhje të objektivave të përcaktuara nga Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve (BIDS) 2021-2027, e cila parashikon kryerjen në total të 7 fushatave të promovimit përgjatë kohëzgjatjes të veprimit të strategjisë.
2. Program i strukturuar për shërbimin e përkujdesjes së mëtejshme
3. Vlerësimi dhe reforma e programit të TEDA-ve.

2.5.3 Zhvillimi i fushatave promovuese për tërheqjen e investimeve

Më datë 19 Prill 2023, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), mori pjesë në panelin e Konferencës së Investimeve të Dhomave të Ballkanit Perëndimor, e organizuar si një aktivitet gjatë mbajtjes së panairit “Hanover Messe 2023”. Konferenca shërbeu për dhënien e informacioneve mbi kuadrin e investimeve, duke përfshirë përfitimet dhe mundësitë e të bërit biznes në rajonin e Ballkanit Perëndimor, por gjithashtu mundësoi shfaqjen e shembujve të investimeve të suksesshme në rajon.

AIDA prezantoi klimën e investimeve në vend, si dhe sektorët prioritarë për tërheqjen e investimeve të huaja, duke e vlerësuar gjithashtu shumë të rëndësishëm bashkëpunimin ndër-rajonal për rritjen e investimeve të huaja në rajon.

Gjatë konferencës u diskutua gjithashtu, edhe mbi Tregun e Përbashket Rajonal, përfitimet dhe mundësitë që ofron për investitorët e huaj në periudhë afatshkurtër dhe afatmesme.

AIDA ishte gjithashtu pjesëmarrëse e Panairit Ndërkombëtar të Tiranës, të zhvilluar në muajin Dhjetor 2023 në Tiranë. Gjatë realizimit të këtij panairi, AIDA mbajti një prezantim për sektorin e bujqësisë dhe mundësitë për investime që ofron ky sektor në Shqipëri.

2.6. AFTERCARE

Gjatë vitit 2023, Sektori Aftercare organizoi 2 fushata në bashki të ndryshme të vendit. Gjithashtu, u organizuan vizita pranë bizneseve të sektorëve të ndryshëm në funksion të axhendave të takimeve të investitorëve të huaj në vendin tonë.

Në vitin që lamë pas, janë zhvilluar 35 takime me subjekte që operojnë në sektorë të ndryshëm, përkatësisht 13 takime me subjekte në turizëm, 8 në manifakturë, 3 në ndërtim, 2 në energji dhe pjesa tjetër e takimeve janë zhvilluar në sektorë si transporti, miniera, agropërpunimi etj. Po kështu 45% e tyre janë me pronësi shqiptare, 17% me pronësi italiane dhe 11% me pronësi gjermane.

Në lidhje me problematikat, 17 subjekte (ose 48% e tyre) nuk raportuan probleme dhe vetëm 6 prej tyre (17%) shprehën shqetësim lidhur me mungesën e fuqisë punëtore. Pjesa tjetër referuan për problematika të natyrës infrastrukturore, pastrimit të kanaleve kulluese etj. Për këto problematika AIDA i është drejtuar insitucioneve përgjegjëse për zgjidhje.

Edhe gjatë vitit 2023 AIDA ka vijuar të jetë pranë bizneseve, duke i asistuar hap pas hapi për problematikat e raportuara, në ndërlidhje me njësitë e qeverisjes vendore dhe qendrore, duke krijuar kështu mundësinë për një komunikim sa më efektiv mes subjekteve dhe enteve shtetërore, me qëllim lehtësimin dhe inkurajimin e riinvestimeve në vend.

2.6.1 Plani i Veprimit Aftercare për vitin 2023

Në vazhden e aktiviteteve dhe takimeve që AIDA organizon pranë bizneseve, gjatë vitit 2023 u zhvilluan fushata Aftercare me kompani të sektorëve të ndryshëm në disa bashki të vendit.

Gjatë gjysmës së parë të vitit, Sektori Investime & Aftercare ndërmorri Fushatën e parë në sektorin e turizmit në bashkitë Durrës, Vlorë dhe Lezhë me 13 takime. Vizitat u organizuan në subjektet kryesore që kryejnë veprimtarinë në sektor.

Qëllimi i takimeve ishte njohja me shërbimet që AIDA ofron, si institucioni përgjegjës për tërheqjen dhe mbështetjen e investimeve të huaja në vend, gjithashtu dhe përftimi i një informacioni më të detajuar sa përket ecurisë së planit të biznesit, problematikat potenciale në prag të sezonit turistik dhe si mund të asistojë AIDA për zgjidhjen e tyre.

Në bashkinë Vlorë u zhvilluan takime pranë Maritim Marina Bay Resort, Chic Boutique Hotel & Spa, Yacht Hotel dhe Hotel Imperial. Përgjithësisht nuk u raportuan problematika, vetëm shqetësime lidhur me hapjen e vazhdueshme të rrugëve për rikonstrukcion, mungesën e kalendarit të aktiviteteve dhe ujërat e zeza.

Në bashkinë Durrës vizitat u zhvilluan pranë bizneseve Melia Durrës, Mövenpick Hotel Lalëz, Epidamn Boutique & SPA dhe Amara Hotel.

Nuk u raportuan problematika, vetëm sugjerime lidhur me siguracionet shoqërore/shëndetësore të punonjësve dhe mosndryshimin e shpeshtë të taksës së hapësirës publike. Vizitat vijuan në bashkinë Lezhë me Maritim Rafaelo Resort & Spa, Prince Adriatik dhe Ermiri Palace. Subjektet referuan për probleme me fuqinë punëtore dhe infrastrukturën jo të përshtatshme, sistemimin e rërës dhe dezinfektimin e vijës bregdetare.

Fushata e dytë u organizua me bashkëpunimin e dhomave gjermane, turke dhe italiane të tregtisë, të cilat vendosën në dispozicion një listë paraprake me kontakte. U takuan subjektet me kapital turk Blunil, Albplast, Beralb dhe Form International (Seramiksan). Kompanitë nuk shprehën problematika me përjashtim të Albplast lidhur me fuqinë punëtore. Albplast sugjeroi dhe subvencionet për kompanitë në riciklim. U vijua me takimet pranë kompanive me kapital gjerman me bashkëpunimin e DIHA-s si Röfix sh.p.k, MK Hotels, Tirana Business Park, Vega Solar dhe Forscher Albania. Përgjithësisht nuk shprehën problematika, me përjashtim të Röfix sh.p.k, për mungesën e fuqisë punëtore dhe pastrimin e kanaleve kulluese. AIDA po asiston kompaninë Forscher për transportin e punonjësve dhe ndërtimin e një kopshti për fëmijët e punonjësve.

Pjesa e tretë e fushatës u fokusua te kompanitë me kapital italian si AGIC Albania, Software Engineering, Mabel International, Duferco dhe Rework. Këto kompani nuk shprehën problematika dhe 3 prej tyre synonin riinvestime, me linja të reja prodhimi dhe zgjerim në hapësirat ekzisuese ku ushtrojnë aktivitetin.

Përpos fushatave të mësipërme, Sektori Investime & Aftercare organizon takime të përkujdesjes ndaj investitorit dhe në kuadër të vizitave të investitorëve të huaj në Shqipëri, duke përmbushur kështu, një detyrë të dyfishtë. Gjithashtu AIDA është pranë kompanive dhe me kërkesë të këtyre të fundit, me vendosje kontaktesh, bashkëpunimi dhe shkëmbimi të dhënash për furnizues potencialë

2.7. IDENTIFIKIMI I PRONAVE ME POTENCIAL PËR INVESTIME

2.7.1. Pronat shtetërore dhe zonat me përparësi zhvillimi

Bazuar në legjislacionin sektorial, propozimi për shpalljen e zonave me përparësi zhvillimi mund të bëhet nga ministritë e linjës, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe Komiteti i Investimeve Strategjike.

Identifikimi, shpallja dhe përcaktimi i mënyrës dhe rregullave të funksionimit të zonave, të cilat do të konsiderohen me përparësi zhvillimi, kryhet rast pas rasti, nga Këshilli i Ministrave, me vendim të posaçëm. Bazuar në VKM nr. 1023/2015, zhvillimi i zonave me përparësi zhvillimi fokusohet, kryesisht, në:

- orientimin e investimeve në zona të caktuara territoriale, me qëllim nxitjen e përqendrimit të llojeve të njëjta apo të ngjashme të industrive apo veprimtarive tregtare, në mënyrë që të përfitohet nga specializimi i punëkërkuësve, ekonomitë e shkallës dhe ndarja e kostove infrastrukturore. Për këtë qëllim do të përdoren mekanizma nxitës, të cilët synojnë rritjen e efikasitetit të infrastrukturave ekzistuese apo në zhvillim, si edhe do të ndërmerren masa për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet industriale;
- orientimin e investimeve në zona të caktuara territoriale, në të cilat ka nivele të larta papunësie dhe ku zhvillimi ekonomik është në nivele të pakënaqshme, krahasuar me rajone të tjera të vendit. Për këtë qëllim do të përdoren mekanizma nxitës, të cilët synojnë zhvillimin ekonomik, rritjen e mirëqenies së popullatës, rritjen e punësimit dhe formimin profesional, si dhe përmirësimin e infrastrukturave.

Gjatë vitit 2023, AIDA ka vazhduar të kryejë verifikimet përkatëse për prona shtetërore të cilat kanë potencial për t'u konsideruar si zona me përparësi zhvillimi dhe rrjedhimisht si zona potenciale për tërheqjen e investimeve të huaja në vend.

Zonat në fjalë, janë zona me potencial për krijimin e një poli ekonomik, të cilat do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik të bashkive përkatëse, çka do të mund të realizohet nëpërmjet investimeve të ndryshme.

Shpallja e një zone me përparësi zhvillimi do të mundësojë rihzhvillimin dhe pasurimin e saj me funksione të ndryshme, duke ndikuar në rritjen ekonomike të zonës.

Objektivi kryesor i shpalljes së një zone me përparësi zhvillimi, do të mundësojë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, duke ruajtur balancat mes sektorëve të ndryshëm të ekonomisë në territor dhe duke rritur konkurrencën dhe larminë ndërmjet sektorëve aktivë të rajonit për të gjeneruar punësim të vazhdueshëm.

Pronat e identifikuar gjatë vitit 2020, vijnë të jenë potenciale për shfrytëzim nga investitorët vendas dhe të huaj, prona si :

- **Ish Kombinati Metalurgjik, Elbasan**
- **Aseti Uzina e Plehrave Azotike, Fier**
- **Aseti Fabrika e Duhan Cigareve, Shkodër**
- **Uzina e telave dhe e kabllove, Shkodër**
- **Ish Vaskat e Peshkut, Korçë**

2.7.2 Rritja e bashkëpunimeve ndërinstytucionale për identifikimin e pronave/ projekteve potenciale

Investimet e huaja përbëjnë një element thelbësor të rritjes dhe zhvillimit ekonomik për çdo shtet. Këto investime luajnë një rol kyç në krijimin e mundësive të punësimit, përmirësimin e infrastrukturës dhe nxitjen e inovacionit. Historiku i bashkëpunimeve deri më sot ka treguar se prezantimi i projekt-fishave të ndryshme para investitorëve ndërkombëtarë fuqizon potencialin e investimeve të huaja.

Për këtë qëllim, AIDA iu drejtua gjatë vitit 2023 ministrive të ndryshme, sipas fushave të përgjegjësisë të secilës, duke kërkuar bashkëpunimin e tyre për dërgimin e fishave të projekteve. Këto fisha projektsh synojnë të shërbejnë si mjete për të shfaqur potencialin dhe përfitimet e projekteve në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, duke nxitur kështu interesin e investitorëve të mundshëm.

Në vijim të kërkesave drejtuar ministrive, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dërgoi një listë me projekte në infrastrukturë aktualisht në proces, ose që priten të zhvillohen në të ardhmen për prezantime dhe financim para investitorëve të huaj.

2.8. INICIATIVA TË DREJTORISË SË INVESTIMEVE PËRGJATË 2023

2.8.1. Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 (BIDS)

Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 (BIDS), është një dokument ligjor me rëndësi të veçantë për zhvillimin e biznesit dhe investimeve, duke e konsideruar adresimin e duhur të tyre si kusht drejt një zhvillimi të qëndrueshëm. Kjo strategji përbën orientimin kryesor të Qeverisë Shqiptare për zhvillimin ekonomik afatmesëm, duke u fokusuar kryesisht në zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme si edhe investimet.

Gjatë vitit 2023, AIDA ka qenë e përfshirë në detajimin e çështjeve të strategjisë të cilat janë të lidhura ngushtësisht me veprimtarinë e AIDA-s. Referuar objektivit të ndërkombëtarizimit të investimeve, fokusi i Agjencisë ka qenë në organizimin e fushatës outreach në sektorin e bujqësisë në Turqi, duke prezantuar potencialet e vendit në këtë sektor.

Gjithashtu, pjesë e rëndësishme e strategjisë janë dhe shërbimet e përkujdesjes ndaj investitorëve ekzistues në Shqipëri, të cilat janë detajuar sa më sipër.

2.8.2 Bashkëpunimi me Invest North Macedonia dhe vizita studimore në Shkup

Në datat 29-30 qershor, Sektori Investime & Aftercare zhvilluan një vizitë studimore në Shkup, Maqedoni e Veriut. Vizita kishte për qëllim shkëmbimin e ideve dhe eksperiencave me fokus zhvillimin e zonave ekonomike teknologjike dhe industriale. Vizita e parë u zhvillua pranë agjencisë homologe Invest North Macedonia, ku stafi i AIDA-s u prit nga Drejtori Ekzekutiv dhe stafi respektiv. Prezantimi fokusohej te ndihma shtetërore që Maqedonia e Veriut ofron për kompanitë, e cila është deri në 50% për sektorë si prodhimi dhe industria përpunuese. Gjithashtu ndihma jepet kur investimi ndodhet në fazën 70% të implementimit, në përputhje me një kontratë 5-vjeçare mes kompanisë dhe shtetit.

Takimi vijues ishte te Drejtoria për Zonat e Zhvillimit Industrial Teknologjik (TIDZ) dhe zonat e lira ekonomike Skopje 1 dhe Skopje 2. Investimet në këto zona janë të përjashtuara nga taksat për një periudhë 10-vjeçare dhe shteti i mbështet financiarisht investimet, duke mbuluar deri 50% të kostove.

Vizitat u përmyllën me angazhimin reciprok për bashkëpunim institucional të vazhdueshëm, në funksion të mbështetjes së zgjerimit të biznesit, rritjes ekonomike dhe sidomos në funksion të shkëmbimit të praktikave më të mira që lehtësojnë investimet dhe zhvillimin.

2.8.3 AIDA organizon Forumin e Biznesit Shqipëri – Gjermani

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), organizoi Forumin e Biznesit Shqipëri - Gjermani. Pjesëmarrësit kryesorë të këtij aktiviteti ishin rreth 40 biznese të reja gjermane të rrjetit “The Young Entrepreneurs” dhe rreth 60 biznese shqiptare me interesa direkte në fushat e bizneseve mike. Vizita e delegacionit gjerman kishte si qëllim njohjen më nga afër me potencialin dhe mundësitë konkrete që ka Shqipëria për investime, njohjen dhe prezantimin me projekte që mbështet Qeveria Shqiptare, por edhe me fusha të reja për investime të mundshme.

Forumi u përshëndet nga Zv/Ministri i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Z. Endrit Yzeiraj, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Znj. Delina Ibrahimaj, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Znj. Frida Krifca, si dhe Ambasadori i Republikës Federale Gjermane në Shqipëri Sh.T. Z. Peter Zingraf.

Prezantimin përmyllës të forumit e mbajti Drejtoresha e Investimeve pranë AIDA-s Znj. Mileva Meksi, duke u ndalur dhe prezantuar në mënyrë të detajuar për pjesëmarrësit mbi klimën e biznesit në Shqipëri, çfarë ofron vendi ynë për investitorët e huaj, incentivat e Qeverisë Shqiptare në të gjithë sektorët prioritarë, marrëveshjet ekonomike, si edhe ndihmën e AIDA-s në këtë proces. Pas përfundimit të prezantimeve, forumi vijoi me takimet B2B (business to business), ku kompanitë gjermane dhe shqiptare patën mundësi të diskutonin dhe shkëmbenin kontaktet për bashkëpunime të mëtejshme.

2.8.4 AIDA organizon Forumin e Biznesit Shqipëri – Poloni

Gjatë muajit maj, u mbajt Tryeza e Rrumbullakët e Biznesit “Poloni – Shqipëri” me pjesëmarrjen e Presidentit të Republikës së Shqipërisë Sh.T.Z. Bajram Begaj dhe Presidentit të Republikës së Polonisë Sh.T.Z. Andrzej Duda. Ky aktivitet u organizua nga Agjencia Polake e Investimeve dhe Tregtisë (PAIH) në bashkëpunim me Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), dhe mori një vëmendje të veçantë për rëndësinë që pati në vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit midis sipërmarrësve nga Polonia dhe Shqipëria dhe shprehjen e ideve konkrete për zgjerim në tregun shqiptar.

Presidenti i Republikës së Shqipërisë Sh.T.Z. Bajram Begaj, shprehu gatishmërinë për bashkëpunim të ngushtë për forcimin dhe zgjerimin e marrëdhënieve ekonomike dhe mbështetjen e ofruar nga shteti mik dhe theksoi potencialin e madh të Shqipërisë, nga ku mund të përfitojnë investitorët polakë.

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve bëri një prezantim të reformave të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare për përmirësimin e klimës së biznesit, duke ndikuar në rritjen e fluksit të investimeve të huaja në 10-vjeçarin e fundit.

Drejtuesit e agjencive homologe, AIDA dhe PAIH nënshkruan Marrëveshjen e Bashkëpunimit, si hap i parë i një procesi të vazhdueshëm me qëllim forcimin e marrëdhënieve të ndërsjellta, por edhe ndarjen e eksperiencave institucionale, për të krijuar rrjetin mbështetës të nevojshëm për kompanitë e dy vendeve. Në përfundim u zhvilluan takimet B2B ndërmjet kompanive polake dhe atyre shqiptare.

2.8.5 Pjesëmarrja e AIDA-s në panaire ndërkombëtare

Më datë 19 Prill 2023, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), mori pjesë në panelin e Konferencës së Investimeve të Dhomave të Ballkanit Perëndimor, e organizuar si një aktivitet gjatë mbajtjes së panairit “Hanover Messe 2023”. Konferenca shërbeu për dhënie të informacioneve mbi kuadrin e investimeve, duke përfshirë përfitimet dhe mundësitë e të bërit biznes në rajonin e Ballkanit Perëndimor, por gjithashtu mundësoi shfaqjen e shembujve të investimeve të suksesshme në rajon.

AIDA prezantoi klimën e investimeve në vend, si dhe sektorët prioritarë për tërheqjen e investimeve të huaja, duke e vlerësuar gjithashtu si shumë të rëndësishëm bashkëpunimin rajonal për rritjen e investimeve të huaja në rajon.

Gjatë konferencës u diskutua gjithashtu, edhe mbi Tregun e Përbashkët Rajonal, përfitimet dhe mundësitë që ofron për investitorët e huaj në periudhë afatshkurtër dhe afatmesëm.

Gjatë tetorit të 2023 AIDA mori pjesë gjithashtu në Javën e Energjisë për Ballkanin Perëndimor, Mali Zi. Emëruesi i përbashkët i kësaj konference ishte tranzicioni energjetik dhe dekarbonizimi. Në këtë event u theksua nevoja e angazhimit të përbashkët, e cila lidhet me kalimin e plotë drejt energjisë së rinovueshme, duke patur në vëmendje eficientë energjetike dhe furnizimin e pandërprerë me energji elektrike.

2.8.6 Rritja e prezencës së AIDA-s në mediat ndërkombëtare

Gjatë vitit 2023, bazuar në mbështetjen financiare të garantuar nga Regional Cooperation Council (RCC), AIDA rriti prezencën e saj në mediat ndërkombëtare, përmes publikimit në revistën ndërkombëtare The European.

Publikimi i broshurave të investimeve në një media apo revistë ndërkombëtare rrit vizibilitetin e Shqipërisë dhe shërbimet e ofruara nga AIDA për një audiencë më të gjerë, duke përfshirë investitorë të mundshëm nga vende të ndryshme të botës. Kjo ndihmon në tërheqjen e investitorëve të rinj dhe rrit besueshmërinë dhe reputacionin e vendit tonë.

The European është një revistë ndërkombëtare, me qendër në Londër, MB, e cila publikon informacione të ndryshme lidhur me investimet e huaja direkte. Shumë agjenci homologe të AIDA-s kanë përdorur shërbimet e The European duke publikuar website-t e tyre me synim rritjen e vizibilitetit kundrejt investitorëve të huaj, pasi numri i vizitorëve për muaj në faqen e The European arrin shifrën 220,000.

Marrëveshja e arritur mes AIDA-s dhe The European parashikoi publikimin e një baneri në faqen e kësaj të fundit, baner i cili në momentin që klikohet të ridrejton në faqen e AIDA-s.

2.8.7 Pjesëmarrja e AIDA në tryeza pune vendimarrëse

2.8.7.1 Pjesëmarrja e AIDA në tryeza pune vendimarrëse

Përgjatë vitit 2023 AIDA ka vazhduar të jetë një ndër aktorët e përfshirë në iniciativat e integritit rajonal. Puna e zhvilluar përgjatë viteve 2017-2020 me MAP REA do të vazhdojë të thellohet nëpërmjet Planit të Ri të veprimit CRM përgjatë viteve 2021-2024.

Gjatë vitit 2023, AIDA nëpërmjet mbështetjes financiare të dhënë nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC), prodhoi disa materiale elektronike dhe të shtypura që përmbajnë informacione të detajuar për sektorët e interesit. Objektivi ishte përdorimi i informacionit të dhënë për të përmirësuar cilësinë e fushatave informuese dhe përpjekjeve të tjera të gjenerimit të leads.

Broshura e turizmit

Duke pasur parasysh rëndësinë e sektorit të turizmit, kjo broshurë tregon veçoritë unike të Shqipërisë me synimin për të tërhequr më shumë investime në turizëm dhe për të rritur të ardhurat për ekonominë e vendit. Kjo broshurë përfshin gjithashtu informacione për fluksin e turistëve, akomodimet, opsionet e transportit, duke treguar një pasqyrë të përgjithshme të këtij sektori.

Përmes prodhimit të kësaj broshure, investitorët e huaj që janë të interesuar të investojnë në industrinë e turizmit, kanë mundësinë të njihen me një pasqyrë të potencialit turistik të vendit, duke përfshirë informacion mbi infrastrukturën ekzistuese, politikat turistike, mundësitë e investimeve dhe stimujt e sektorit turistik si dhe masat lehtësuese.

2.8.7.2 Pjesëmarrje në diskutimet për "Investment Facilitation for Development" nga OBT

Përgjatë 2023 AIDA, së bashku me MFE, ka qenë pjesë e diskutimeve për lehtësimin e investimeve për zhvillim nga OBT, të cilat po zhvillohen në sfondin e një marrëdhënieje në rritje dhe përforsuese midis tregtisë

dhe investimeve, e cila ka potencialin për të nxitur rritjen ekonomike dhe diversifikimin, krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Iniciativa nisi me Ministerialin e Buenos Aires-it në vitin 2015.

Në dhjetor 2017, 70 anëtarë të OBT-së nga të gjitha kontinentet dhe në të gjitha nivelet e zhvillimit lëshuan një Deklaratë të Përbashkët për Lehtësimin e Investimeve për Zhvillim, duke bërë thirrje për "diskutime të strukturuar" që synojnë zhvillimin e një kuadri shumëpalësh për lehtësimin e investimeve për zhvillim. Në nëntor 2019, 98 anëtarë të OBT-së u angazhuan në një deklaratë të dytë të përbashkët për Lehtësimin e Investimeve për Zhvillim (IFD) për të intensifikuar punën për zhvillimin e një marrëveshjeje për lehtësimin e investimeve të huaja direkte në lidhje me mallrat dhe shërbimet dhe për të punuar drejt një rezultati konkret.

Në vitin 2020 u zhvillua një dialog informal mbi lehtësimin e investimeve, me pjesëmarrje të hapur dhe në 2023 më shumë se 100 vende pjesëmarrëse ranë dakord mbi tekstin përfundimtar të IFD. Gjithashtu në fund të vitit 2023 u mbyllën teknikalitetet dhe aspektet ligjore të marrëveshjes.

Marrëveshja do të fokusohet në investimet e huaja direkte në gjithë sektorët e ekonomisë, duke patur si synim rritjen e tyre edhe në cilësi, në transparencë, qartësi etj. Synohet që përmes kësaj marrëveshjeje informacioni të bëhet lehtësisht i aksesueshëm, të përmirësohen procedurat e dhënies së autorizimeve dhe lejeve, procesi dhe kohëzgjatja e tyre të jenë të qarta dhe të parashikueshme.

Ky tekst ndodhet në një hap të rëndësishëm drejt përmblyljes pasi është gati për miratimin e shteteve anëtare.

2.7. INVESTIMET STRATEGJIKE

2.7.1. Hyrje

Me hyrjen në fuqi të paktës së re ligjore për investimet strategjike (datë 24.12.2015), u bë e mundur që investimet e vendase dhe të huaja, në sektorët më të rëndësishëm të shpallur strategjikë, të lëvizin më me shpejtësi, me procedura të përshpejtuara dhe favorizuese.

Në zbatim të kësaj pakete ligjore, AIDA ka tre funksione të tjera shtesë:

- One Stop Shop për aplikimet për investim/ investitor strategjik;
- Sekretariat Teknik i Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS);
- Agjent asistues i investitorit strategjik;



Referuar legjislacionit të investimeve strategjike, AIDA në cilësinë e One Stop Shop ka të gjithë autoritetin e nevojshëm për të pranuar dosjet, shqyrtuar, kontrolluar përputhshmërinë e aplikimeve, dhe më pas të koordinojë vendimmarrjen.

Në këtë aspekt, One Stop Shop:

- kryen veprimet përgatitore dhe shërbimet e nevojshme ndaj projektit potencial strategjik dhe investitorit/investitorëve potencialë strategjikë (pra dy stative të ndryshme), veçanërisht ato të verifikimit të tokës dhe përputhjes së projektit të investimit me planet kombëtare të rregullimit të territorit (proces i cili përfshin një sërë institucionesh njëkohësisht);
- koordinon procesin vlerësues të një projekti nga Grupi Operacional, me shpejtësi dhe efikasitet (brenda një afati maksimal prej 30 ditësh);
- përgatit raportet për KIS, në rolin e Sekretariatit Teknik dhe harton një sërë aktesh administrative pas vendimeve të KIS.

Duke qenë se procedurat kanë krijuar tashmë precedent, edhe mbledhjet e KIS për një projekt janë reduktuar. (Ligji 55/2015 parashikon që KIS ka 30 ditë pune afat për të marrë një vendim lidhur me një projekt investimi që i propozohet nga grupi operacional). Njëkohësisht sipas ligjit, KIS, pasi aprovon statusin strategjik, duhet të miratojë dhe planin e veprimit (masat shtetërore) për projektin në shqyrtim. Për këtë arsye, Grupet Operacionale japin kontributin e tyre, njëkohësisht, edhe për vlerësimin teknik të projektit, edhe për planin e veprimit mbi masat shtetërore që vlerësohen se duhet t'i jepen projektit. Mbi këtë bazë, Sekretariati Teknik paraqitet në KIS me dy materiale njëherazi: (i) raportin e vlerësimit teknik dhe (ii) planin e veprimit. Afati 30 ditor shfrytëzohet për të zbardhur vendimin dhe rekomandime shtesë të KIS.

2.7.2. Projekte të vlerësuara nga Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS) përgjatë vitit 2022 dhe 2023

Projekte të shqyrtuara nga AIDA 2020-2021

VITI	2022	2023	TOTALI
Projekte totale	12	16	28
Projekte të miratuara	4	6	10
Projekte të refuzuara	2	10	12
Shqyrtime të tjera të miratuara*	6	4	10

Përveç sa më sipër, përgjatë vitit 2022 AIDA ka asistuar në fazë paraprake edhe 21 projekte, të cilat, për arsye të ndryshme nuk janë pranuar si aplikime ose subjektet aplikues nuk kanë vijuar me aplikimin përfundimtar, duke e çmuar atë për një moment të dytë.

* Shqyrtimet e tjera që ka bërë KIS përgjatë vitit 2022 kanë të bëjnë me:

- ndryshimin e vendimeve të Komitetit të Investimeve Strategjike për 4 projekte;
- mospranimin e ndryshimit të 1 projekti;
- anulimin e një vendimi të KIS të 1 projekti;

2.7.3. Projektet sipas sektorëve strategjikë


Projektet e shqyrtuara përgjatë vitit 2022 i përkasin sektorit të turizmit, i cili ka numrin më të madh të projekteve të investimit (3), duke u ndjekur më pas nga sektori i agroturizmit (1).

Në krahasim me vitin 2021, në vitin 2022 janë trajtuar:


- 4 projekte në sektorin e turizmit, prej të cilëve janë miratuar 3 dhe është refuzuar 1;
- 2 projekte në sektorin e agroturizmit, prej të cilëve janë miratuar 2;

Të shprehura në formë grafike:

Në vitin 2022, projektet në sektorin e turizmit zunë 65% të projekteve të miratuara në total., ndërkohë që sektori i agroturizimit zuri 20 % dhe 20 % të tjera.



Në vitin 2023, projektet në sektorin e turizmit zunë 50% të projekteve të miratuara në total, ndërkohë që sektori i bujqësisë zuri 33 % dhe 17 % të tjera.



2.7.4. Rezultatet si pasojë e aplikimit të legjislacionit të investimeve strategjike

Duke pasur parasysh aplikimin e legjislacionit për investimet strategjike, si dhe shtimin e numrit të investitorëve që kërkojnë aplikimin e masave asistuese apo mbështetëse nga AIDA dhe shteti shqiptar, duhet theksuar se ka një vlerësim tepër pozitivisht mbi kuadrin ligjor ekzistues, pavarësisht se, në fillimet e zbatimit të tij, investitorët mund të kenë qenë edhe skeptikë me efektivitetin e zbatimit të tij. Por sot, është fakt se ky legjislacion është liberal, jo diskriminues për investitorët, qofshin këta vendas apo të huaj, si dhe transparent, në drejtim të incentivave dhe programeve sektoriale, me anë të të cilit janë thjeshtëzuar edhe më tej procedurat administrative.

Tashmë, si pasojë e aplikimit të legjislacionit të investimeve strategjike, projektet e investimit që aplikojnë dhe asistohen nga AIDA kanë më shumë lehtësira në marrjen e lejeve zhvillimore apo lejeve të ndërtimit, kurse masat mbështetëse janë lehtësisht të zbatueshme dhe me procedura të përshpejtuara.

Zbatimi i ligjit përgjatë kësaj periudhe ka krijuar një rrjet komunikimi ndërinstytucional shumë funksional. Së fundmi, përfshirja në ligj e zonave me prioritet zhvillimi, si një sektor strategjik, përbën një mekanizëm akoma dhe më efikas për të akomoduar investime strategjike me impakt të theksuar social dhe ekonomik për zona të veçanta.

Ligjit të investimeve strategjike Nr.55/2015, i ndryshuar, i ka përfunduar afati i aplikimeve më datë 31.12.2023. Aktualisht, ky ligj është në proces rishikimi pranë Komisioneve Parlamentare.

3 NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME

3.1.HYRJE

Drejtoria NVM dhe Projekte pranë AIDA-s ka si objektiv të ofrojë shërbime për mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) shqiptare nëpërmjet asistencës teknike, promovimit të bizneseve shqiptare në tregjet ndërkombëtare, si dhe krijimin e lidhjeve dhe të mundësive të bashkëpunimit me bizneset e huaja. Drejtoria ndihmon ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në shfrytëzimin e financimeve publike, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NVM) luajnë një rol kyç në ekonominë e Shqipërisë dhe në zhvillimin e vendit. Kjo shprehet nëpërmjet treguesve të punësimit në sektorin privat dhe kontributit të tyre në të ardhurat kombëtare. Ndërmarrjet e kësaj madhësie ofrojnë një bazë të qëndrueshme për ekonominë vendase dhe janë motori i inovacionit dhe zhvillimit të bizneseve në nivele të ndryshme të shoqërisë.

Duke ofruar mundësi për punësim dhe krijimin e të ardhurave, ato ndikojnë në rritjen ekonomike dhe përmirësimin e mirëqenies së popullsisë.

Drejtoria për NVM dhe Projekte është në përpjekje të kthejë këto potenciale në avantazh konkurrues për ekonominë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

3.1.2.Ndërmarrje aktive (përgjashtuar fermerët), në 2022

- 113.460 është numri i ndërmarrjeve në fund të vitit 2022 duke shënuar një rritje prej 9,1% krahasuar me vitin 2021;
- 15.700 ndërmarrje janë regjistruar gjatë vitit 2022, nga 14.946 të regjistruar gjatë vitit 2021;
- 86,6% e ndërmarrjeve janë prodhues të shërbimeve, nga 86,6% që ishin respektivisht në vitin 2021;

- 113.460 është numri i ndërmarrjeve në fund të vitit 2022 duke shënuar një rritje prej 9,1% krahasuar me vitin 2021;
- 15.700 ndërmarrje janë regjistruar gjatë vitit 2022, nga 14.946 të regjistruar gjatë vitit 2021;
- 86,6% e ndërmarrjeve janë prodhues të shërbimeve, nga 86,6% që ishin respektivisht në vitin 2021;
- Në bashkinë Tiranë janë përqendruar pjesa më e madhe e ndërmarrjeve aktive;
- Ndërmarrjet e mëdha me 50 e më shumë të punësuar zënë vetëm 1,6% ndaj totalit të ndërmarrjeve. Kontributi i tyre në punësim llogaritet në 50.6% në vitin 2022, nga 51,1% në vitin 2021;
- 5,6% e ndërmarrjeve janë ndërmarrje të huaja e të përbashkëta, nga ku 40,3% e tyre janë me origjinë nga Italia dhe 5,1% nga Greqia;
- Numri i të punësuarve gjithsej në ndërmarrjet aktive në fund të vitit 2022 është 547,942 nga 519.239 që ishte në fund të vitit 2021. (+28.703 të punësuar).

3.1.3. Ndërmarrjet aktive grupuar sipas numrit të të punësuarve në vitin 2022

Ekonomia shqiptare është e fokusuar kryesisht në aktivitetin tregtar dhe shërbime të tjera. Ndërmarrjet me aktivitet tregtar numërojnë 29,9% ndaj totalit të ndërmarrjeve të regjistruara gjatë vitit 2022. Aktiviteti tregtar realizon edhe xhiron vjetore më të madhe në ekonomi, me 39,6% Rreth 85,6% e ndërmarrjeve janë ndërmarrje të vogla me 1-4 të punësuar dhe kontributi i tyre llogaritet në 21,7% në punësim dhe 17,8% në realizimin e xhiros vjetore.

Ekonomia shqiptare është e fokusuar kryesisht në aktivitetin tregtar dhe shërbime të tjera. Ndërmarrjet me aktivitet tregtar numërojnë 29,9% ndaj totalit të ndërmarrjeve të regjistruara gjatë vitit 2022. Aktiviteti tregtar realizon edhe xhiron vjetore më të madhe në ekonomi, me 39,6% Rreth 85,6% e ndërmarrjeve janë ndërmarrje të vogla me 1-4 të punësuar dhe kontributi i tyre llogaritet në 21,7% në punësim dhe 17,8% në realizimin e xhiros vjetore. Ndërmarrjet me 50 e më shumë të punësuar përfaqësojnë 1,7% të totalit të ndërmarrjeve, punësojnë 51,1% të të punësuarve gjithsej, dhe realizojnë 46,5% të totalit vjetor të xhiros. Rreth 64,1% e ndërmarrjeve janë përqendruar në qarqet Tiranë, Durrës dhe Fier.

Gratë menaxhojnë/zotërojnë 31,1% të ndërmarrjeve gjithsej. Aktiviteti "Tregtia me pakicë, përveç tregtisë së automjeteve dhe motorçikletave" shënon pjesëmarrjen më të lartë të grave në vendimmarrje, me 42%. Ndërmarrjet e drejtuara nga gratë janë kryesisht ndërmarrje me 1- 4 të punësuar. Gratë zënë 45,7% të të punësuarve gjithsej dhe janë fokusuar më së shumti në aktivitetin ekonomik "Shërbime të tjera", me 54,9%. Sektori me përfaqësimin më të ulët të grave është sektori i ndërtimit.

3.2. PLATFORMA "AKSESI NË FINANCË"

Përveç funksionit si urë lidhëse midis bizneseve dhe burimeve të financimit, nëpërmjet platformës "Akses në Financë" AIDA promovon mundësitë për financime të reja duke ndihmuar në identifikimin e burimeve të financimit si donacione, subvencione, kredi bankare, ose investime të tjera të kapitalit. Gjithashtu, AIDA ofron dhe grante buxheti i shtetit me synimin mbështetjen në mënyrë të drejtpërdrejtë të ndërmarrjeve shqiptare. Kjo mbështetje do të jepet përmes një procesi konkurrues të thirrjes për propozime, i cili do të jetë i konceptuar për të identifikuar dhe financuar projektet që kontribuojnë në rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Platforma "Akses në Financë"

Portali "Akses në Financë" (<https://aidasmefinance.gov.al/>) është një burim i rëndësishëm për bizneset vendase, duke ofruar informacion të përditësuar për mundësitë e burimeve financiare, grantet, kreditë dhe nisma të tjera financiare.

Kjo platformë online siguron një shërbim "one stop shop" me informacione që lidhen drejtpërdrejt me aksesin në financë për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NVM), duke ofruar informacion nga institucione, organizata dhe kompani private dhe publike, si nga nivelet kombëtare dhe ndërkombëtare. Ndërtimi i platformës "Akses në Financë" është realizuar me rekomandimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, dhe ka pasur mbështetjen e Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). AIDA, si zbatuesja kryesore e kësaj nisme, ka qenë pjesë e ndjekjes, asistimit dhe kontributit në krijimin e platformës, në bashkëpunim me kompaninë e zhvillimit të saj. Platforma u lancoi në maj të vitit 2021 dhe aktualisht përditësohet rregullisht nga AIDA me thirrje të reja dhe mundësi financimi për bizneset, duke ofruar asistencë dhe përgjigje rast pas rasti për kompanitë e interesuara për të aplikuar. Deri më tani, në platformë janë publikuar në total 117 thirrje për aplikim për grante ose skema të tjera financiare, duke u vizituar 244,864 herë. Mesatarisht, në platformë publikohen 3 thirrje të reja në muaj. Nga shkalla e frekuentimit, vërehet se thirrjet më të vizituara janë ato që janë fokusuar në inovacion, teknologji dhe arsim. Moshë mesatare e vizitorëve është 25-34 vjeç, ndjekur nga vizitorët e moshës 18-24 vjeç. Vizitorët e platformës janë më së shumti nga Shqipëria, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Italia, Kosova dhe Mbretëria e Bashkuar. Deri më tani, 277 subjekte janë regjistruar për të marrë buletin elektronik të thirrjeve, prej të cilave 147 janë NVM dhe 130 janë persona fizik.

Grant nga Buxheti Shtetit

Granti i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2024 do të administrohet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

Ky grant përfaqëson një mundësi për NVM-të për të përshpejtuar rritjen e tyre dhe për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit.

Për vitin 2024, detajet rreth kriterëve të aplikimit, dokumentacionit të kërkuar, afateve të aplikimit dhe procedurave të vlerësimit do të bëhen të ditura shumë shpejt përmes një njoftimi zyrtar nga AIDA.

Ky informacion do të jetë i disponueshëm, në faqen zyrtare dhe do të promovohet në mënyrë aktive përmes kanaleve të komunikimit dhe zhvillimit të sesioneve informuese.

3.3 NISMA PËR ZHVILLIMIN E SIPËRMARRJEVE MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME

- U përditësuan dhe u shtuan informacione për profilet e kompanive në platformën online B2B të faqes së AIDA-s, sipas formatit të ri. Në këtë platformë janë në total, 1192 profile të kompanive shqiptare, me qëllim vizibilitetin e tyre ndaj partnerëve potencialë për bërjen e biznesit brenda dhe jashtë vendit.
- Vijimi i fushatës për promovimin e produkteve "Made in Albania". Është bërë identifikimi i produkteve vendase për fushatën "Zgjidh të Vendit" dhe përshkrimi i tyre. Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023 është realizuar promovimi në mediat sociale të institucionit i 42 produkteve lokale.
- Publikimi i katalogut të katërt të produkteve "Made in Albania". Katalogu prezanton në përmbajtjen e tij rreth 30 produkte për periudhën gusht-dhjetor 2023.
- Zhvillimi i katër tryezave të rrumbullakëta për sektorët Lëkurë-këpuce, fruta-perime, bimë medicinale dhe ICT, me përfaqësues të aktorëve kryesor të secilit sektor, nga institucionet publike, subjektet private dhe universitetet. Në këto tryeza morën pjesë në total 100 përfaqësues.
- Pjesëmarrje dhe kontribute në grupe pune ndërinstitucionale dhe aktorë në ekosistemin e sipërmarrjeve.
- AIDA ishte pjesë e aktivitetit "PREMA SHOW CASE", i organizuar nga GIZ Albania në kuadër të projektit (ProSeed 2.0) mbi certifikimin e trajnereve dhe kompanive të përzgjedhura me metoden Prema.
- Në kuadër të promovimit të eksporteve AIDA ishte pjesë e takimit online me përfaqësuesit e DAF (Danish Albanian Association) dhe 4 kompani Daneze, me qëllim nxitjen e eksporteve midis dy vendeve.
- AIDA ishte pjesëmarrëse e takimit të organizuar nga MFE, në kuadër të përgatitjeve për Takimin dypalësh me shërbimet e BE për kapitullin 20 "Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale" të zhvilluar në datat 25 -26 maj 2023 në Bruksel.
- AIDA zhvilloi një takim me Drejtuesit e Ministrisë së Tregtisë dhe Ndërmarrjes së Kosovës, për mundësitë e bashkëpunimit midis dy institucioneve në sektorin e Artizanatit dhe të Inovacionit.
- AIDA zhvilloi një takim me Unionin e Prodhuesve të Verës. Takimi u zhvillua në kuadër të nxitjes së bashkëpunimit mes AIDA-s dhe Unionit të Prodhuesve të Verës.
- AIDA zhvilloi një takim me përfaqësues të Shoqatës Shqiptare të E-Commerce. Qëllimi i takimit ishte bashkëpunimi mes AIDA-s dhe AECA-s në kuadër të disa objektivave të përbashkëta në sektorin e-commerce.
- Në kuadër të projektit: "Fuqizimi Ekonomik i Grave dhe perspektiva gjinore në zinxhirin e vlerave të biznesit", i mbështetur nga Gender Equity and Equality Action (GEEA) i Departamentit të Shtetit, AIDA në bashkëpunim me Qendren Aleanca Gjinore për Zhvillim (GADC), organizoi në ambientet e saj, trajnimin me temë "Brilliant Entrepreneur", në mbështetje të grave sipërmarrëse.
- Pjesëmarrje e stafit të AIDA-s në trajnim 3-ditor, të organizuar nga International Trade Center, në ambientet e MBZHR-s.
- Takim me ekspertë të GIZ Albania dhe ekspertë të GIZ Maqedoni Albania me qëllim shkëmbim eksperience për promovimin e eksporteve në agrikulturë.
- Duke filluar nga muaji dhjetor 2023, AIDA ka marrë pjesë në trajnimin me temë "Ngritja e kapaciteteve të AIDA për Kërkimin e Tregut", organizuar nga GIZ Albania.
- Takim me ekspertë të GIZ Albania dhe shoqatës Federale Gjermane të sektorit organik lidhur me mundësitë e bashkëpunimit mes kompanive shqiptare dhe gjermane të sektorit organik.
- Takim me ekspertë të huaj në kuadrin e projektit IPA TWINING "Fuqizimi i ekosistemit të shkencës dhe kërkimit shkencor në Shqipëri" organizuar nga AKKSHI me qëllim mbledhjen e rekomandimeve për reformimin e legjislacionit për kërkimin shkencor dhe inovacionin.
- Pjesëmarrje dhe prezantim në eventin "SIPPO Annual Meeting".
- Pjesëmarrje dhe prezantim i shërbimeve të AIDA-s në aktivitetin e organizuar nga Dhoma e Biznesit të Diasporës, Dhoma Ekonomike e Gruas dhe CIPE me teme: Identifikimi, vlerësimi, mentorimi dhe asistimi për akses në financë i mundësive në ekonominë digjitale për gratë sipërmarrëse.
- Pjesëmarrje në takimin me Kryeministrin e Shqipërisë në eventin: "Albania uses AI to Build Connections with Europe".

3.4 KONFERENCA DHE FORUME

- Pjesëmarrje dhe prezantim në aktivitetin Gratë Sipërmarrëse në Ballkanin Perëndimor. Ky forum u organizua nga Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim, në bashkëpunim me AZHBR, Dhoma Ekonomike e Grave, Regional Cooperation Council.
- Pjesëmarrje dhe prezantim në Samitin e III-të të Diasporës "Diaspora Shqiptare për Zhvillimin e Qëndrueshëm" organizuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë & Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe Klimës së Biznesit.
- Pjesëmarrje dhe prezantim në forumin e biznesit Shqipëri- Sllovaki, organizuar nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë dhe Dhoma Ekonomike Sllovaqe.
- Pjesëmarrje në eventin "Shqiperia Inteligjente". Prioritetet dhe Vizioni për të Ardhmen", në mbyllje të fazës EDP, në kuadër të hartimit të strategjisë S3.
- Pjesëmarrje në eventin lancues të Innovation Challenge Fund EU4INNOVATION.

3.5 PANAIRET DHE AKTIVITETET: MBËSHTETJE NË RITJEN E KONKURRUESHMËRISË DHE PROMOVIMIT TË NMVM-VE.

Një nga funksionet e AIDA-s është forcimi i konkurrueshmërisë dhe pranisë së kompanive shqiptare në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare.

AIDA me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë, nxitjen e eksporteve, si edhe promovimin e bizneseve shqiptare, ka organizuar dhe marrë pjesë në 7 panaire, 3 kombëtare dhe 4 ndërkombëtare, në sektorët kyç të ekonomisë si: Pije Ushqim, Bimë medicinale dhe aromatike, Fruta -Perime dhe Tekstile.

AIDA shërbeu si urë lidhëse për bizneset shqiptare, duke koordinuar të gjitha aspektet e pjesëmarrjes dhe duke siguruar që kompanitë të kishin infrastrukturën e nevojshme për të prezantuar produktet e tyre në mënyrë efektive.

Gjithashtu, AIDA ndihmoi bizneset shqiptare në gjetjen e partnerëve të huaj dhe në zhvillimin e marrëdhënieve të biznesit me qëllim të rritjes së eksporteve dhe për të bërë produktet shqiptare më të njohura në tregjet ndërkombëtare.

Pjesëmarrja në këto panaire solli histori suksesi dhe nënshkrim të marrëveshjeve tregtare, duke rritur eksportet dhe të ardhurat për bizneset shqiptare.

Janë mbështetur 41 kompani shqiptare, realizuar rreth 1025 kontakte me një vlerë të pritshme eksportesh 9.5 milionë euro. Përveç organizimit dhe mbështetjes së kompanive shqiptare, AIDA vazhdon të ketë një rol kyç në monitorimin dhe ndjekjen e procesit të realizimit të marrëveshjeve të arritura gjatë panairit.

Përmbledhje e panairove dhe aktiviteteve mbështetëse të organizuara nga AIDA:

- Organizimi dhe pjesëmarrja në panairin "EXPO FOOD", në datat 18-20 Mars 2023, në Athinë, Greqi. AIDA mbështeti 5 kompani shqiptare të sektorit "Pije & Ushqim".
- Organizimi dhe pjesëmarrja me standë në panairin "Ditët e Bujqësisë", në datat 27-29 Maj 2023, në Lushnje.
- Organizimi dhe pjesëmarrja me standë në panairin "MACFRUT 2023", në datat 03-05 Maj 2023, në Rimini, Itali. AIDA mbështeti 5 kompani shqiptare të sektorëve bimëve medicinale dhe fruta-perime. Për realizimin e panairit, AIDA bashkëpunoi me Swiss Import Promotion Programme (SIPPO) dhe projektin "Kukës New Perspective" të mbështetur nga Swiss Contact, me qëllim vazhdimin e misionit për promovimin e produkteve "Made in Albania" dhe gjetjen e tregjeve të reja.
- Organizimi dhe pjesëmarrja me standë në panairin kombëtar "Food & Drinks" në datat 23-25 Maj 2023 në Tiranë, të organizuar nga EXPO CITY. AIDA mbështeti 10 kompani të sektorit të ushqimit dhe pijeve. Nën logon "Made in Albania", kompanitë pjesëmarrëse patën mundësinë të promovonin produktet e tyre dhe të takonin klientë dhe blerës, ku shkëmbyen dhe kontaktet për mundësi bashkëpunimi të mëtejshme. Në këtë panair gjithashtu, AIDA ishte pjesë e Forumit "Sfidat e Agropërpunuesve".

- Organizimi dhe pjesëmarrja me standë në panairin ndërkombëtar "ISPO MUNICH", në datat 28-30 nëntor 2023, në Mynih, Gjermani. AIDA mbështeti 5 kompani të sektorit të veshjeve sportive. Ky panair u realizua në bashkëpunim me Swiss Import Promotion Programme Albania (SIPPO) dhe shoqatën Pro Export Albania.
- Pjesëmarrja në aktivitetin e zhvilluar me temë "Mundësi biznesi në industrinë e fruta & perimeve dhe bimëve medicinale dhe aromatike, për sipërmarrësit shqiptarë", organizuar në datën 15 nëntor 2023, në Tiranë nga organizatorët e panairit MACFRUT.
- Pjesëmarrja me standë në panairin Ndërkombëtar të Tiranës, në datat 4-7 dhjetor 2023, në pallatin e Kongreseve, organizuar nga Klik Ekspo Group.
- Workshop online, i organizuar nga SIPPO Albania në kuadër të përgatitjeve për pjesëmarrje në "Biofach 2024", në Nuremberg, Gjermani.
- Workshop online, i organizuar nga SIPPO Albania dhe project Intracen (ITC-Trade Promotion East) me kompanitë e sektorit të bimëve medicinale dhe të vajit të ullirit në kuadër të përgatitjeve për pjesëmarrje në panairin "Biofach 2024".
- Takim me kompanitë pjesëmarrëse në Panairin "Biofach 2024" organizuar nga AIDA së bashku me SIPPO Albania dhe projektin Intracen (ITC-Trade Promotion East) në kuadër të fillimit përgatitjeve për panairin e bimëve medicinale dhe të vajit të ullirit.
- Organizimi dhe pjesëmarrja me standë në panairin ndërkombëtar "BIOFACH 2024", në datat 13-16 Shkurt, në Nuremberg, Gjermani. AIDA mbështeti 6 kompani të sektorit të produkteve organike. Ky panair u realizua me mbështetjen e projektit Intracen (ITC-Trade Promotion East) dhe në bashkëpunim me Swiss Import Promotion Programme Albania (SIPPO).

3.6 MBËSHTETJA E PRODUKTIT 'MADE IN ALBANIA' DHE PLATFORMA 'B2B'

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) ka ndërmarrë një fushatë të rëndësishme për promovimin e produkteve 'Made in Albania'. Përmes kësaj fushate, synohet të nxitet ndërgjegjësimi për cilësinë dhe diversitetin e produkteve shqiptare në tregun lokal dhe ndërkombëtar. Në të njëjtën kohë, AIDA ka vënë theks të veçantë në përditësimin dhe avancimin e platformës B2B, duke u përpjekur të lehtësojë bashkëveprimin e bizneseve vendase me partnerët potencialë jashtë vendit. Këto nisma synojnë të fuqizojnë bizneset shqiptare dhe të ndihmojnë në zgjerimin e prezencës së tyre në tregjet globale.

• Promovim i Produkteve "Made in Albania"

'Zgjidh të vendit' është fushata promovuese e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në mbështetje të bizneseve shqiptare dhe produkteve 'Made in Albania'.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023 është realizuar promovimi në rrjetet sociale të institucionit i 40 produkteve lokale. Në kuadër të nismës për promovimin e produkteve "Made in Albania", Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve publikoi "Zgjidh të Vendit", katalogun e katërt të produkteve "Made in Albania".

Katalogu prezanton në përmbajtjen e tij 30 produkte për periudhën janar-dhjetor 2023.

• Platforma "BUSINESS TO BUSINESS"

Platforma "Business to Business", (B2B) është një rrjet aktiv, i cili ofron mundësinë për bashkëpunime dhe investime të suksesshme midis bizneseve. Kjo platformë është një "mekanizëm" lehtësues që krijon mundësi për bashkëpunime frytdhënëse dhe për të zgjeruar kontaktet në botën e biznesit. Në platformën online B2B të faqes së AIDA-s, në fund të vitit 2023 kanë qenë në total të publikuar 1192 profile të kompanive shqiptare, me qëllim vizibilitetin e kompanive ndaj partnerëve potencialë për bërjen e biznesit.

Për t'u njohur me platformën B2B vizitoni linkun: <http://aida.gov.al/b2b/>

3.7 PUBLIKIME

- Broshura “EXPO FOOD përmban një përmbledhje të sektorit Pije&Ushqim si dhe profilet e 5 kompanive pjesëmarrëse në panairin “EXPO FOOD”, zhvilluar në Athinë, Greqi. Për më shumë informacion, linku: https://aida.gov.al/wcontent/uploads/2024/01/Broschure_finale.pdf;
- Broshura "Macfrut 2023". Broshura përmban një përmbledhje të sektorit të Bimë medicinale dhe aromatike dhe të fruta-perimeve, si edhe profilet e 5 kompanive pjesëmarrëse në panairin “Macfrut 2023”, zhvilluar në Rimini, Itali. Për më shumë informacion, linku: https://aida.gov.al/wcontent/uploads/2024/01/Broschura_Final_Macfruit_compressed.pdf;
- Pyetësi për “Vlerësimin e nevojave për trajnim në ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme shqiptare”. Rezultatet dhe gjetjet e pyetësit u pasqyruan në raportin përmbledhës “Analiza e pyetësit mbi nevojat e NVMV-ve për trajnim”.
- Broshura informuese “Ndërkombëtarizimi i NMVM-ve, “Certifikimet” dhe Botimi “Manual për pjesëmarrjen e NMVM-ve në panairë”.
- Pyetësi “Mbi identifikimin e nevojave dhe kërkesave të grave sipërmarrëse Rezultatet dhe gjetjet e pyetësit u pasqyruan në raportin përmbledhës “Analiza mbi pyetësin mbi identifikimin e nevojave dhe kërkesave të grave sipërmarrëse”
- Pyetësi “Mbi identifikimin dhe përzgjedhjen e panairëve ndërkombëtarë për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, të sektorëve Lëkurë-Këpuçë, Tekstile, Agropërpunim, Bujqësi, dhe ICT. Rezultatet dhe gjetjet e pyetësit u pasqyruan në raportin përmbledhës “Analiza e pyetësit të panairëve”.
- Broshura “Ispo Munich 2023”, e cila përmban një përmbledhje të sektorit të tekstileve dhe veshjeve sportive si dhe profilet e 5 kompanive pjesëmarrëse në panairin “Ispo Munich 2023”, zhvilluar në Mynih, Gjermani Për më shumë informacion, linku: <https://aida.gov.al/wcontent/uploads/2024/02/ISPO-Brochure.pdf>
- Kalendari vjetor i panairëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë si dhe botimi i katërt i katalogut “Zgjidh të Vendit”.
- Në këtë katalog u promovuan rreth 30 produkte të reja të identifikuara “Made in Albania”. Për sa i takon sektorëve kryesorë të promovuar, kryeson

sektori i agropërpunimit dhe sektori kozmetik dhe produkte të kujdesit personal Analiza e rezultateve të pyetësit të eksporteve, e kryer nga AIDA, i është dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për të vijuar me hartimin e Programit “Për nxitjen e eksporteve dhe ndërkombëtarizimin 2022-2027.

3.8.PROJEKTE TË MENAXHUARA NGA AIDA

Gjatë vitit 2023, AIDA ka menaxhuar dhe implementuar projektin “Aftësi për Punësim të Qëndrueshëm dhe Rritje Ekonomike Gjithëpërfshirëse të Rajonit Ndërkufitar të Shqipërisë dhe Malit të Zi – Aftësi për Punësim Shqipëri – Mal i Zi”, pjesë e programit IPA II të financuar me fonde nga Bashkimi Europian, ka mbështetur individë dhe ndërmarrje mirko, të vogla dhe të mesme nëpërmjet thirrjeve të ndryshme për aplikim, në kuadër të zbatimit të projektit.

Qëllimi kryesor i këtij projekti është nxitja e punësimit dhe përfshirja sociale duke lehtësuar hyrjen në tregun e punës për të rinjtë dhe gratë në zonat ndërkufitare të Shqipërisë dhe Malit të Zi. Target-grupi i synuar përfshin punëkërkuessit me nivel të ulët dhe të mesëm arsimimi, nivel të ulët kualifikimi dhe me aftësi që nuk përputhen me kërkesën e tregut të punës, të rinjtë (mosha 15 deri në 29 vjeç) dhe gratë që kërkojnë punësim.

AIDA është pika kryesore e të gjitha aktiviteteve që zhvillohen në Shqipëri, që nga identifikimi dhe koordinimi i pjesëmarrësve në trajnim dhe mentorim, si dhe punëdhënësve dhe bizneseve që do të përfshihen në këtë projekt.

Aktivitetet e përfshira në implementimin e këtij projekti realizohen mes Shqipërisë (Bashkia Shkodër, Bashkia e Vaut të Dejës, Bashkia e Malësisë së Madhe) dhe Malit të Zi (Podgoricë, Tuz, Budva, Bar, Ulqin, Danilovgrad dhe Cetinje). Kohëzgjatja totale e implementimit të këtij projekti është 24 muaj, duke filluar nga muaji Shkurt 2023.

Gjatë vitit 2023, AIDA mbështeti target-grupin e synuar nëpërmjet ofrimit:

- Trajnime në punë: Nëpërmjet trajnimit praktik në punë, kjo thirrje synon të aftësojë individët pjesëmarrës për të qënë sa më konkurrues në tregun e punës, si dhe të shërbejë si një dritare për mundësi punësimi me kohë të plotë pranë bizneseve ku janë trajnuar. Nga kjo thirrje, u përzgjedhën 14 pjesëmarrës dhe 9 biznese, të cilët u trajnuan për një periudhë 3 mujore kundrejt mbulimit të shpenzimeve në formën e dietave,

në vlerën 450 euro bruto për çdo muaj të trajnimit. Gjithashtu, 9 mentorët e përfshirë në trajnimin e individëve u kompensuan në vlerën 200 euro bruto për çdo muaj të trajnimit.

- Trajnim profesional për udhërrëfyes turistik kombëtar: Duke qënë se turizmi është një sektor prioritar për zhvillimin e zonave të përfshira në projekt, kurset e trajnimit profesional për udhërrëfyes turistik janë një mundësi e mirë të rinjtë për të zhvilluar aftësitë e tyre profesionale dhe për të qënë të punësueshëm gjatë sezonit turistik. Trajnimi zhvillohet nga një subjekt i licensuar për ofrimin e këtij trajnimi, i përzgjedhur nëpërmjet një thirrjeje për aplikim të dedikuar, dhe u ofrohet në total 5 individëve të përzgjedhur. Trajnimi ka filluar që prej muajit Shkurt 2024 dhe kohëzgjatja totale e tij është 4 muaj duke përfshirë të mësuarit teorik, si dhe atë praktik. Në përfundim të trajnimit, individët do të pajisen me certifikata pjesëmarrjeje. Gjatë vitit 2024, projekti do të vijojë me thirrje të reja të cilat do të konsistojnë në ofrim mentorimi, këshillimi për plane biznesi dhe financime me grante për idetë më të mira të biznesit që do të përzgjidhen.

4 DREJTORIA MARKETING DHE KËRKIM ANALIZË

4.1. Hyrje

Drejtorja Marketing dhe Kërkim Analizë ka për funksion sigurimin e Komunikimit dhe Marketingut të institucionit për politikën, prioritetet, aktivitetet, fushatat etj. Po ashtu, kjo drejtori ka për funksion kërkim dhe analizën në lidhje me variabla të ndryshme që AIDA i ka në fokus t'i mbulojë në përmbushje të ligjit të saj organik.

Misioni i Drejtorisë Marketing dhe Kërkim Analizë është arritja e objektivit mbi informacionet mbi tregun dhe strategjive të reja, me qëllim kërkimin në vazhdimësi për mundësi të reja investimi në Shqipëri. Drejtorja Marketing dhe Kërkim Analizë siguron informacione mbi tregun dhe strategjitë e reja, kryen studime tregu dhe kërkim të dhënash me qëllim përditësimin e materialeve dhe informacioneve në funksion të drejtorive dhe investitorëve.

Drejtorja e Marketing dhe Kërkim Analizë në mbështetje të drejtorive të tjera të Agjencisë, përgjatë vitit 2022, krahas rritjes së kanaleve të komunikimit, përmirësoi përmbajtjen dhe cilësinë e komunikimit.

4.2. Publikime në media sociale

Drejtorja Marketing dhe Kërkim Analizë ka mundur në vazhdimësi përditësimin me informacion, si edhe pasqyrimin në kohë, në të gjitha kanalet e komunikimit (Website, Facebook, Instagram, LinkedIn, Twitter). Të gjitha aktivitetet, takimet zyrtare, konferencat, trajnimet, seminare dhe panairët, janë pasqyruar në faqen Web dhe në Rrjetet Sociale

publikimeve në gjuhën shqipe dhe angleze, si edhe shoqërimet me foto, video dhe infografe ilustruese. Të gjitha postimet në rrjetet sociale janë të shoqëruara me link nga faqja zyrtare e AIDA-s, në mënyrë që të promovohet faqja zyrtare e institucionit, si edhe për ta bërë më të aksesueshme nga publiku.

Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë ka ndjekur dhe monitoruar të gjitha informacionet mbi veprimtarinë e AIDA-s, grupeve të interesit, investitorëve, partnerëve dhe ka informuar publikun e gjerë nëpërmjet mediave elektronike dhe faqes zyrtare www.aida.gov.al në kohë reale. Një rëndësi të veçantë i është kushtuar organizimit të aktiviteteve dhe përmirësimit të imazhit duke siguruar që të dhënat, lajmet dhe materialet promovuese të Agjencisë të shpërndahen në mënyrë periodike nëpërmjet rrjeteve sociale dhe faqes zyrtare të internetit.

4.2.1. AIDA Website

Faqja web e AIDA-s, përmban informacione të rëndësishme në ndihmë të investitorëve, kompanive vendase, si edhe ato të huaja. Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë është angazhuar në menaxhimin dhe përditësimin e përmbajtjes së faqes zyrtare të web-it të Agjencisë, www.aida.gov.al, kontenti i së cilës ofrohet në gjuhën shqipe dhe angleze. Përditësimi i faqes zyrtare bëhet në baza të rregullta duke reflektuar praktikën më të mira ndërkombëtare dhe nëpërmjet një marketing miks synon tërheqjen e një numri në rritje të investitorëve potencialë për të vizituar faqen.

Përgjatë vitit 2023, faqja zyrtare web ka pasur një numër të konsiderueshëm vizitorësh, nga vendi ynë por edhe nga vende të huaja. Në total numri i vizitorëve ishte 7734, nga ku 62% e vizitorëve ishin nga Shqipëria dhe 38% nga vende të huaja. Ndër vizitorët e vendeve të huaja, kryesonin ata nga Franca (15%), nga SHBA (10%), nga Italia (9%), nga Kosova (7%) dhe nga Gjermania (7%). Vitin e ardhshëm, AIDA do vijë me një faqe të re zyrtare web, për ristrukturimin e të cilës po punohet intensivisht që prej muajit nëntor 2023. Faqja e re web, është akoma në proces ndërtimi dhe e konceptuar për të qenë inovatore në dizajn dhe më atraktive. Njëkohësisht do mundësojë një eksperiencë më interaktive dhe tërheqëse për vizitorët e faqes. Një nga risitë e kësaj faqeje të re web do jetë edhe “Albania Smart Map”, një hartë inteligjente e Investime Strategjike të Shqipërisë, me projektet e asistuar nga AIDA, me qëllimin që vizitorët e faqes të zbulojnë Shqipërinë dhe të njihen me potencialin e saj të investimeve.

4.2.2. Rrjete sociale

AIDA mbulon me informacione edhe nëpërmjet rrjeteve sociale, për t’ju ardhur në ndihmë të palëve të interesuara, si dhe për ta bërë më të lehtë marrjen e informacionit. Aktualisht AIDA ka në përdorim faqet: Facebook - AIDA - Albanian Investment Development Agency, Instagram - @aida__albania, LinkedIn - AIDA - Albanian Investment Development Agency, Twitter - @investinalbania.

AIDA Facebook

Faqja e facebook ka një audiencë të lartë, numër i cili ka ardhur duke u rritur vazhdimisht. Faqja facebook përditësohet vazhdimisht duke ofruar informacione mbi aktivitetet e ardhshme dhe të zhvilluara, mbi investimet dhe klimën e të bërit biznes, rritjen ekonomike etj. Për vitin 2023 janë bërë 281 postime.

AIDA Twitter

AIDA është aktive edhe në rrjetin social twitter, duke publikuar dhe ndarë me ndjekësit informacione të rëndësishme. Për vitin 2023, janë bërë 108 postime gjithsej. Faqja zyrtare AIDA-s, së bashku me rrjetet sociale (Facebook, Twitter, Instagram, LinkedIn), kanë qënë shumë aktive dhe një asistencë e rëndësishme për të gjithë aktorët dhe bizneset të cilët vizitojnë faqen zyrtare dhe rrjetet sociale të AIDA-s, për tu njohur në kohë reale me të gjitha informacionet e pasqyruara. Në total, në të gjitha adresat e AIDA-s janë bërë 786 postime.

AIDA Instagram

Agjencia ka në përdorim edhe një faqeje instagrame, për informim të të gjithë palëve të interesuara mbi shërbimet dhe rolin e institucionit, si edhe për njohje nga një masë me e gjerë. Për vitin 2023, janë bërë gjithsej 264 publikime.

AIDA LinkedIn

AIDA ka aktualisht dhe një faqe në rrjetin social LinkedIn për të qënë më afër ndjekësve të saj. Për vitin 2023, në rrjetin social LinkedIn janë bërë 133 postime.

4.2.3. Prezantimet video

Përgjatë vitit 2022, AIDA ka publikuar 7 video. Përgatitja e formateve video ka si qëllim të jape një mesazh dhe njohë kompanitë NMVM, në mënyrë konkrete dhe për ta bërë sa më të prekshme, ndihmën që AIDA.

ofron nëpërmjet mbështetjes së kompanive për pjesëmarrjen në panaire, gjetjen e klientëve potencialë dhe nënshkrimin e kontratave. Videot gjithashtu trajtojnë çështje dhe ndajnë eksperiencat mbi mënyrën e të bërit biznes në Shqipëri dhe zhvillimin e mëtejshëm të tij, video të aktiviteteve të veprimtarisë së AIDA-s, si edhe video mbi pjesëmarrjen e Shqipërisë në Expo 2020 Dubai

Histori Suksesi - New Born

<https://aida.gov.al/stories/new-born/>

Histori Suksesi - Green Coast

<https://aida.gov.al/stories/test-test/>

History Suksesi - San Pietro

<https://aida.gov.al/stories/yura-corporation-albania-shpk/>

Me rastin e pjesëmarrjes për here të parë të AIDA, si përfaqësuese e standës së Shqipërisë, me prezencën e pesë kompanive shqiptare, në panairin e veshjeve sportive ISPO MUNICH 2023, u realizua një video promovuese.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në panairin ISPO MUNICH 2023

<https://www.facebook.com/investinalbania/videos/1401319574119828/>

Për të promovuar tek investorët e huaj dhe vendas, faktet pozitive për Shqipërinë në publikimin e Bankës Botërore “Gratë, Biznesi dhe Ligji 2023”, u realizua një video.

Publikimi i Bankës Botërore – Gratë, Biznesi dhe Ligji 2023

<https://www.facebook.com/reel/377519064614424/>

Gjithashtu, me rastin e festave të fundvitit, AIDA ka realizuar një video në formën e një mesazhi urimi dhe ftese bashkëpunimi në vitin e ri, për çdo sipërmarrës shqiptar dhe të huaj.

Video e urimit të festave të fundvitit

<https://www.facebook.com/investinalbania/videos/715126314045412/>

4.2.4. Botimet e AIDA-s

Përgjatë vitit 2023, në kuadër të rritjes së vizibilitetit dhe informimit, AIDA ka hartuar dhe dizenuar materiale promovuese (digjitale dhe fizike), me fokus investitorët potencialë dhe kompanitë NMVM. Botimet prezantojnë dhe promovojnë misionin dhe qëllimin e institucionit, si dhe pasqyrojnë informacione të rëndësishme mbi ekonominë e vendit tonë, sektorëve potencialë për investime, si edhe iu vijnë në ndihmë kompanive NMVM, për tu zgjeruar në tregun e huaj. Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë në bashkëpunim me drejtoritë e tjera siguroi përditësimin e materialeve dhe u kujdes për përshtatjen, dizenjimin, botimin dhe vendosjen e tyre në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë, për t'i bërë sa më të aksesueshme.

Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë gjatë vitit 2023 pati në fokus zhvillimin dhe përgatitjen e shërbimeve të marketingut në mbështetje të drejtorive të tjera. Një rëndësi ju kushtua cilësisë së përmbajtjes së informacionit të materialeve promovuese, si dhe plotësimin të kërkesave të legjislacionit në fushën e botimit.

4.2.4.1 Botime për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme

“Ndërkombëtarizimi i NMVM shqiptare, certifikimet”

https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2023/12/CERTIFIKIMET_2023.pdf

Kjo broshurë pasqyron një përmbledhje mbi arsyet e përse duhet të certifikohen NMVM-të shqiptare, përfitimet e certifikimit, llojet e tyre dhe trupat certifikuese.

Guida për pjesëmarrjen e NMVM në panaire

https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2023/12/Guid_Panairret_2023_compressed-1.pdf

AIDA, nëpërmjet realizimit të guidës për pjesëmarrjen e NMVM në panaire, ka për qëllim t’ju vijë në ndihmë ndërmarrjeve, lidhur me objektivat e pjesëmarrjes në panair, identifikimin e panairit më të përshtatshëm, kriteret e vendimmarrjes, planifikimin dhe pjesëmarrjen.

“New perspective on sports” ISPO Munich 2023

<https://www.facebook.com/investinalbania/posts/pfbid0qJmRQU2h7juoJwPTR8DpmS1ZMAC8Ts5bgtCjfA7S3QJc9qBXMWncaqo1RreK2gFeXl>

Broshura informuese “New perspective on sports”, është realizuar në kuadër të pjesëmarrjes në panairin ISPO Munich 2023. Broshura bën një përshkrim të përgjithshëm të zhvillimit të sektorit të veshjeve të punës në Shqipëri, si edhe përmban 5 profilet e kompanive shqiptare që ishin pjesë e pavijonit shqiptar në panairin ISPO Munich 2023, si edhe gamën e produkteve që prodhojnë.

FOOD EXPO

https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/Broshure_finale.pdf

Broshura “FOOD EXPO, GREECE”, ofron një përmbledhje të sektorit ushqimit dhe pijeve në Shqipëri, si edhe prezanton profilet e pesë kompanive shqiptare që ishin pjesë e pavijonit shqiptar në këtë panairi, së bashku edhe me gamën e produkteve përkatëse.

MACFRUT 2023

https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/Broshura_Final_Macfruit_compressed.pdf

Broshura informuese “MACFRUT 2023, Rimini Expo Center, Italy, Albania Pavilion”, ofron një përmbledhje të sektorit bujqësor në Shqipëri (fruta-perimeve dhe farave/bimëve), si edhe prezanton profilet e pesë kompanive shqiptare që ishin pjesë e pavijonit shqiptar në panairin MACFRUT, Itali, si dhe gamën e produkteve që ato kanë.

“Zgjidh të Vendit”- Katalogu i tretë dhe i katërt i produkteve “Made in Albania”

<https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/Katalogu-made-in-albania-3-Shqip.pdf>

Katalogu i tretë është një përmbledhje e produkteve “Made in Albania”, për periudhën Gusht 2021 - Korrik 2022.

https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/Katalogu_4_Shqip_UPD.pdf
Katalogu i katërt është një përmbledhje e produkteve “Made in Albania”, për periudhën Gusht 2022 – Dhjetor 2022.

4.2.4.2 Botime për promovimin e Investimeve Strategjike**Invest in Albania**

https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/AIDA_Investors_Brochure_Final.pdf

Broshura “Invest in Albania” është një përmbledhje e pozicionit dhe demografisë së Shqipërisë, klimës pozitive për investime, arsyet përse duhet investuar në vendin tonë dhe sektorët potencialë.

Bring Your Business to Albania

https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/Bring_Your_Business_in_Albania_2023-compressed.pdf

Ky botim në gjuhën angleze përmban informacione të përditësuara statistikore mbi arsyet pse të investosh në Shqipëri dhe përshkruan në mënyrë konkrete ligjin mbi investimet strategjike dhe incentivat për sektorët me potencial zhvillimi si: Energjia, Turizmi, Agroturizmi, Manifaktura, Agrikultura dhe Zonat e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA). Ky botim i AIDA-s i drejtohet të gjithë investitorëve potencialë dhe prezanton lehtësirat e të bërit biznes në Shqipëri.

Factsheet sectors

https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/Tourism_FactSheet_2023.pdf

https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/Manufacture_FactSheet_2023.pdf

https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/IctBPO_FactSheet_2023.pdf

https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/Energy_FactSheet_2023.pdf

https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/agriculture_FactSheet_2023.pdf

Broshurat Factsheet për sektorët e “Turizmit, Manufactures, ICT & BPO, Renewable Energy, Agriculture”, janë botime vjetore të përditësuara dhe pasqyrojnë zhvillimin e sektorëve kyç në Shqipëri, incentivat e qeverisë dhe skemat ekzistuese që mbështesin zhvillimin e secilit sektor.

4.2.4.3. Raporti Vjetor 2022

https://aida.gov.al/wpcontent/uploads/2023/12/Raport_i_Vjetor_2022.pdf

Raporti Vjetor 2022, prezanton ecurinë e zhvillimeve përgjatë vitit 2022, të arritjeve dhe punës së Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve dhe në mënyrë specifike të drejtorive në përbërje të saj.

4.3. AIDA NË AKTIVITETE

4.3.1. Aktivitete lokale me qëllim mbështetjen dhe informimin e biznesit

Drejtorja Marketing dhe Kërkim Analizë kujdeset për organizimin, marketimin dhe promovimin e aktiviteteve apo eventeve të realizuara nga AIDA apo aktiviteteve ku AIDA është pale pjesëmarrëse.

AIDA, në funksion të përmbushjes së veprimtarisë së saj, ndërmerr të gjitha nismat e nevojshme në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat dhe të përmirësimit të klimës së biznesit, duke ndjekur dhe ndihmuar subjektet tregtare private në të gjitha fazat e veprimtarisë së tyre ekonomike, si dhe duke ndërmjetësuar e bashkëpunuar me organet shtetërore. Agjencia, me qëllim fuqizimin dhe rritjen e aftësive konkurruese të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, siguron të dhëna të nevojshme për bizneset dhe mundëson përhapjen e tyre, nëpërmjet ndërtimit të një rrjeti shkëmbimi të informacioneve.

Përgjatë vitit 2023, AIDA ka organizuar në mënyrë të vazhdueshme aktivitete, sesione informuese dhe takime me bizneset, me qëllim informimin e tyre mbi shërbimet kryesore që AIDA ofron.

4.3.2 Panairët dhe roli i AIDA-s në mbështetjen ndaj bizneseve

Roli i Drejtorisë Marketing dhe Kërkim Analizë në pjesëmarrjen e AIDA në panairë lidhet me organizimin dhe marketimin e realizimit të standës së Shqipërisë në panairët ndërkombëtarë apo standës së AIDA në panairë kombëtarë. Kjo përfshin fazat që nga përzgjedhja e panairit, hartimi i strategjisë marketing dhederi në promovimin pas panairit të rezultateve të arritura.

Mbështetja e bizneseve shqiptare për të marrë pjesë në panairë jashtë vendit është një ndihmë e veçantë e qeverisë shqiptare, nëpërmjet AIDA-s për të nxitur biznesin vendas dhe veçanërisht atë eksportues.

AIDA nëpërmjet mbështetjes apo organizimit të pjesëmarrjes në panairë synon promovimin e biznesit shqiptar në sektorë specifikë, mundësimin e takimeve me kompanitë e interesuara për partneritet dhe mbështetjen e kompanive shqiptare me logjistikë për takimet e planifikuara, rritjen e eksportit në këtë sektor, tërheqjen e investitorëve të huaj për investime në vend dhe promovimin e Shqipërisë.

Nëpërmjet pjesëmarrjes në panairë kombëtare dhe ndërkombëtare, AIDA promovon produktet dhe shërbimet shqiptare në tregjet ndërkombëtare, për të reklamuar dhe për të lehtësuar eksportin e produkteve "Made in Albania".

4.3.3 Pjesëmarrja në Panairë Kombëtare dhe Ndërkombëtare

Përgjatë vitit 2023, AIDA ka marrë pjesë në 3 panairë kombëtarë dhe në 3 panairë ndërkombëtarë. Për secilën nga këto pjesëmarrje, Drejtorja Marketing dhe Kërkim Analizë ka bashkëpunuar me Drejtorinë NVM dhe Projekte, duke realizuar një përfaqësim dinjitoz të AIDA në panairët e përzgjedhura.

FOOD EXPO 2023

Në datë 23 Mars 2023, AIDA me mbështetjen e Swiss Import Promotion Programme (SIPPO), organizoi pjesëmarrjen e pesë kompanive shqiptare në panairin më të madh të ushqimeve dhe pijeve në Evropën Juglindore "FOOD EXPO 2023", Greqi. Kompanitë shqiptare si: Birra Korça Sh.p.k., Biobes Sh.p.k., Salvia Produkte Natyrore Sh.p.k., Enofama Sh.p.k., Bidaj Sh.p.k., ekspozuan dhe promovuan produktet Made in Albania gjatë 3 ditëve të panairit.

Drejtorja Marketing dhe Kërkim Analizë ka marrë pjesë në organizimin e standës së Shqipërisë në këtë panair. Kështu, nga ana e drejtorisë është realizuar hartimi i strategjisë marketing, dizejnimi i standës së Shqipërisë, asistencën e kompanive mbi marketimin e tyre në panair. Gjithashtu, është krijuar dhe një broshurë unike lidhur me pjesëmarrjen në këtë panair dhe materiale marketing promovuese, që përfshijnë karta me kod që skanohet për shfaqjen e broshurës digjitale, në mbështetje kjo me tendencat e fundit.

Pjesëmarrja në FOOD EXPO 2023 është promovuar edhe përmes rrjeteve sociale të AIDA, duke paraqitur përmes postimeve ecurinë e pjesëmarrjes dhe rezultatet e arritura, si edhe në faqen zyrtare web.

Ditët e Bujqësisë 2023

Në datat 27 - 29 Prill 2023, në Lushnjë, u zhvillua panairi "Ditët e Bujqësisë 2023", Panairi Ndërkombëtar i Bujqësisë së Qëndrueshme, Blegtorisë, Peshkimit dhe Inovacionit. AIDA ishte pjesëmarrëse në këtë panair, ku promovoi sektorin e bujqësisë dhe produktet "Made in Albania", duke informuar bizneset dhe palët e interesuara mbi shërbimet dhe asistencën që ofron, si edhe mundësinë për bashkëpunim dhe partneritet me pjesëmarrësit.

Lidhur me këtë pjesëmarrje me standë të AIDA, Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë ka marrë pjesë në fazën e organizimit, duke qenë në komunikim direkt me organizatorët e eventit. Kështu është hartuar strategjia marketing, dizajnimi i standës së AIDA, asistenca e kompanive dhe marketimi i pjesëmarrjes. Stafi i drejtorisë ka qenë present në standë, duke informuar vizitorët, bashkë me pjesëtarë të tjerë të AIDA dhe gjithashtu përmes postimeve në kanalet e komunikimit të AIDA është promovuar kjo pjesëmarrje.

MACFRUT 2023

Në datat 3-5 Maj 2023, AIDA në bashkëpunim me Swiss Import Promotion Programme (AIDA) dhe Swisscontact, organizuan pjesëmarrjen e tetë kompanive shqiptare në panairin MACFRUT 2023, që u zhvillua në Rimini, Itali. AIDA mundësoi organizimin e një pavijoni dinjitoz dhe mundësoi promovimin e kompanive në tregun e huaj me prespektivën e shtrirjeve të reja, si edhe lindjen e bashkëpunimeve apo lidhjen e kontratave me kompani të huaja.

Pjesë e organizimit të pjesëmarrjes së AIDA me standën e Shqipërisë në këtë panair ndërkombëtar ishte edhe Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë. Stafi i drejtorisë ka realizuar hartimin e strategjisë marketing, ka dizajnuar standën e Shqipërisë dhe ka dhënë asistencë kompanive mbi marketimin e tyre në panair. Për këtë panair është krijuar dhe një broshurë unike lidhur me pjesëmarrjen e AIDA dhe materiale marketing promovuese, si karta me kod që skanohet për shfaqjen e broshurës digjitale, në mbështetje kjo me tendencat e fundit marketing dhe ekologjike.

Gjithahstu, pjesëmarrja në MACFRUT 2023 është promovuar para, gjatë dhe pas panairit, përmes rrjeteve sociale të AIDA dhe faqes web, duke paraqitur përmes postimeve këtë përfaqësim.

Food & Drink Expo

Në datat 23-25 Maj 2023, AIDA mori pjesë me 10 kompani shqiptare në panairin kombëtar "Food & Drink Expo 2023". Gjatë ditëve të panairit, kompanitë pjesëmarrëse të standës së organizuar nga AIDA nën logon "Made in Albania", ishin: "Vaj Ulliri Valmi", "Djathë Veleçiku", "HidroFarm", "Subashi Olive Oil", "Luga e Argjendhtë", "Prodhime Tradicionale Pogradeci", "Birraria e Gjyshit", "Di Pro Bio", "Nëna Dashuri", "Ferma Arion Gorka". Këta prodhues shqiptarë ekspozuan dhe promovuan produktet e tyre, që u degustuan nga vizitorët e panairit.

Pjesëmarrja në "Food & Drink Expo 2023" mundësoi njohjen e kompanive nga vizitorët e interesuar vendas edhe të huaj, si edhe promovimin e gamës së gjerë të produkteve që ofronin, duke i dhënë mundësinë e bashkëpunimeve të reja, ku edhe stafi i Drejtorisë ishte present në standë për informim të vizitorëve.

Krahas pjesëmarrjes në standë, Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë ka hartuar strategjinë marketing dhe ka dizajnuar standën e AIDA, nën tematikën "Made in Albania". Gjithashtu, është realizuar edhe promovimi i pjesëmarrjes në të gjitha fazat e saj, përmes kanaleve të komunikimit të AIDA.

ISPO Munich 2023

Në datat 28-30 Nëntor 2023, AIDA në bashkëpunim me SIPPO dhe shoqatën Pro Eksport Albania organizuan pjesëmarrjen e pesë kompanive shqiptare në panairin "ISPO Munich 2023", që u zhvillua në Mynih, Gjermani. Gjatë tre ditëve të panairit, kompanitë shqiptare të sektorit të veshjeve sportive dhe tekstileve, përkatësisht "DBS Group", "Jonian Konfeksion", "Mi-Le-Ge-H", "All Brothers" dhe "Ola1" ekspozuan dhe promovuan produktet e tyre në standën e Shqipërisë.

Stafi i Drejtorisë Marketing dhe Kërkim Analizë ka realizuar hartimin e strategjisë marketing dhe ka dizajnuar standën e Shqipërisë. Gjithashtu ka krijuar materiale promovuese për këtë pjesëmarrje, si një broshurë unike lidhur me pjesëmarrjen e AIDA, video promovuese për shfaqje në standë, si karta me kod që skanohet për shfaqjen e broshurës digjitale, në mbështetje kjo me tendencat e fundit marketing dhe ekologjike.

Pjesëmarrja në ISPO Munich 2023 është promovuar para, gjatë dhe pas panairit, përmes rrjeteve sociale të AIDA dhe faqes web, duke paraqitur përmes postimeve këtë përfaqësim dhe rezultatet e arritura.

Panairi Ndërkombëtar i Tiranës

Në datat 06 – 09 dhjetor 2023, AIDA ishte pjesëmarrëse me standë në Panairin Ndërkombëtar të Tiranës, të mbajtur në Pallatin e Kongreseve. Gjatë ditës së parë të panairit, AIDA mbajti një prezantim për sektorin e bujqësisë dhe mundësitë për investime në këtë sektor, në vendin tonë.

Stafi i Drejtorisë dhe pjesa tjetër e stafit të AIDA-s ishte prezentë gjatë ditëve të panairit për të asistuar dhe dhënë informacion çdo kompanie pjesëmarrëse shqiptare dhe të huaj, si edhe palëve të tjera të interesuara që vizituan panairin.

Drejtorja Marketing dhe Kërkim Analizë, krahas hartimit të strategjisë marketing dhe ka dizajnuar edhe standën e AIDA dhe ka promovuar pjesëmarrjen në këtë panair.

Tryeza të rrumbullakëta sektoriale në mbështetje dhe zhvillim të kompanive shqiptare

AIDA ka organizuar disa tryeza të rrumbullakëta me përfaqësues të institucioneve të linjës, ekspertë të sektorëve përkatës, partner, si edhe kompani shqiptare për diskutimin e sfidave dhe identifikimit të nevojave të sektorit. Gjatë takimeve pjesëmarrësit kanë diskutuar rreth nevojave të sektorëve përkatës, përmirësimit, hallkat e sektorëve, strategjive, standardeve dhe parametrave të BE-së, inovacionit, promovimit të produkteve “Made in Albania”, si dhe pjesëmarrjen në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare.

Tryezat e rrumbullakëta që janë zhvilluar kanë qenë:

- o 13 Qershor 2023 - Tryeza e rrumbullakët me aktorët e sektorit të Bimëve Medicinale dhe Aromatike;
- o 20 Qershor 2023 - Tryeza e rrumbullakët me aktorët e sektorit Tekstil & Lëkurë – Këpucë
- o 27 Qershor 2023- Tryezë e rrumbullakët me aktorët e sektorit Pije dhe Ushqim;
- o 9 Nëntor 2023 - Tryezë e rrumbullakët me aktorët e sektorit të Fruta-Perimeve.

Drejtorja Marketing dhe Kërkim Analizë ka marrë pjesë në organizimin dhe promovimin e tryezave të rrumbullakëta të realizuar nga AIDA përgjatë vitit 2023. Për të organizuar këto tryeza, janë realizuar ftesat dhe axhendat, si edhe janë ftuar pjesëmarrësit përmes adresës zyrtare elektronike të AIDA. Realizimi i këtyre takimeve është promovuar në rrjetet sociale të AIDA dhe në faqen zyrtare web.

4.3.4 Forume Biznesi për tërheqjen e investimeve të huaja

Forumi Shqipëri – Gjermani

Më datë 28 Prill 2023, u zhvillua Forumi i Biznesit Shqipëri – Gjermani e organizuar nga AIDA. Pjesëmarrësit kryesorë të këtij aktiviteti ishin rreth 40 biznese të reja gjermane të rrjetit “The Young Entrepreneurs” dhe rreth 60 biznese shqiptare. Vizita e delegacionit gjerman kishte si qëllim njohjen më nga afër me potencialin dhe mundësitë konkrete që ka Shqipëria për investime, njohjen dhe prezantimin me projekte që mbështet Qeveria Shqiptare, por edhe me fusha të reja për investime të mundshme.

Drejtorja Marketing dhe Kërkim Analizë ka kontribuar në realizimin e këtij aktiviteti, në fazën parapërgatitore, në zhvillimin e aktivitetit dhe në promovimin e tij. Kështu, janë përgatitur ftesat, dizajnuar axhenda dhe njoftimi i pjesëmarrësve përmes kanaleve të komunikimit të AIDA. Gjatë zhvillimit të aktivitetit, stafi i drejtorisë ka qenë prezent duke u kujdesur për mbarëvajtjen e forumit dhe takimeve B2B dhe duke u siguruar për regjistrimin e momenteve për promovimin e aktivitetit. Më tej, promovimi i zhvillimit të aktivitetit është bërë përmes publikimeve në rrjetet sociale të AIDA dhe në faqen zyrtare web.

Forumi Poloni-Shqipëri

Më datë 11 Maj 2023, u mbajt Tryeza e Rrumbullakët e Biznesit “Poloni – Shqipëri”, me pjesëmarrjen e Presidentit të Republikës së Shqipërisë Sh.T.Z. Bajram Begaj dhe Presidentit të Republikës së Polonisë Sh.T.Z. Andrzej Duda. Ky aktivitet i bashkëorganizuar nga Agjencia Polake e Investimeve dhe Tregtisë (PAIH) dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), mori një vëmendje të veçantë për rëndësinë që pati në vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit midis sipërmarrësve nga Polonia dhe Shqipëria dhe shprehjen e ideve konkrete për zgjerim në tregun shqiptar.

Stafi i Drejtorisë ka marrë pjesë në zhvillimin e këtij aktiviteti, duke siguruar dhe regjistruar momentet e tij me qëllim promovimin dhe duke u kujdesur për mbarëvajtjen e tij. Gjithashtu, aktiviteti është promovuar përmes kanaleve të komunikimit të AIDA.

Samiti i III-të i Diasporës Shqiptare

Më datë 23 Nëntor 2023, në kuadër të aktivitetit të Samitit të III-të të Diasporë Shqiptare, u mbajt paneli “Diaspora Shqiptare për Zhvillimin e Qëndrueshëm”. Pjesë e panelit ishte edhe Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, Znj. Laura Plaku (Saro). Znj. Plaku, përshëndeti të pranishmit në aktivitet dhe foli mbi nismat që AIDA ka ndërmarrë për përfshirjen e diasporës shqiptare si një faktor thelbësor në prezantimin e vendit tonë ndaj investitorëve të huaj, urat lidhese midis diasporës dhe zhvillimit të sektorëve prioritarë në Shqipëri, si dhe strategjitë që AIDA ndërmerr mbi mënyrën e zhvillimit të këtyre urave lidhese, duke theksuar mbështetjen e ambasadorëve shqiptarë.

Drejtorja është kujdesur për promovimin e prezencës në panel të Drejtorit Ekzekutiv të AIDA dhe promovimin e aktivitetit në rrjetet sociale të AIDA dhe në faqen zyrtare web.

Aktivite lokale me qëllim mbështetjen dhe informimin e biznesit

AIDA, në funksion të përmbushjes së veprimtarisë së saj, ndërmerr të gjitha nismat e nevojshme në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat dhe të përmirësimit të klimës së biznesit, duke ndjekur dhe ndihmuar subjektet tregtare private në të gjitha fazat e veprimtarisë së tyre ekonomike, si dhe duke ndërmjetësuar e bashkëpunuar me organet shtetërore. Agjencia, me qëllim fuqizimin dhe rritjen e aftësive konkurruese të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, siguron të dhëna të nevojshme për bizneset dhe mundëson përhapjen e tyre, nëpërmjet ndërtimit të një rrjeti shkëmbimi të informacioneve.

Përgjatë vitit 2023, AIDA ka organizuar në mënyrë të vazhdueshme aktivite, sesione informuese dhe takime me bizneset, me qëllim informimin e tyre mbi shërbimet kryesore që AIDA ofron.

4.4. Fushata marketing të AIDA-s

Fushata “Zgjidh të vendit”

“Zgjidh të vendit” është fushatë promovuese e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në mbështetje të bizneseve shqiptare dhe produkteve “Made in Albania” e cila ka nisur në korrik të vitit 2020 dhe përfundoi në fund të vitit 2023.

Qëllimi i kësaj fushate ishte që të njohim, zgjedhim dhe duam çdo ditë produktet shqiptare.

Fushata u realizua përmes publikimit të 42 infografeve gjatë vitit 2023, të produkteve shqiptare, që do të përmblihen në një katalog.

Në vitin e ardhshëm, AIDA do të vijojë promovimin e produkteve vendase, por do të zhvillohet me një koncept të ri, për një promovim sa më interaktiv dhe efektiv, për të forcuar markën “Made in Albania” në tregje të huaja.

5 DREJTORIA E KOORDINIMIT

Si koordinator brenda Drejtorisë së Koordinimit, përgjegjësitë tona kryesore përfshijnë ruajtjen dhe edukimin e marrëdhënieve institucionale me subjekte të ndryshme, si brenda dhe jashtë vendit. Kjo nënkupton lehtësimin e komunikimit dhe bashkëpunimit efektiv me institucionet dhe organet brenda dhe jashtë vendit, duke siguruar njëkohësisht koordinimin me drejtorinë e ndryshme brenda AIDA-s.

Një aspekt thelbësor i rolit tonë është të lidhemi me institucionet që merren me punët e jashtme dhe trupin diplomatik për të organizuar dhe mbikëqyrur logjistikën e delegacioneve të biznesit, vizitave, forumeve dhe aktiviteteve të tjera.

Për më tepër, Drejtoria Koordinuese ka detyrën kryesore të matjes dhe vlerësimit të performancës së institucionit, të informojë politikatat dhe të alokojë burimet në mënyrë efektive.

Përveç përgjegjësiave thelbësore brenda Drejtorisë së Koordinimit, ne luajmë një rol vendimtar në zbatimin e planeve të veprimit që rrjedhin nga Strategjia Kombëtare, veçanërisht ato integrale në procesin e shqyrtimit në negociatat me BE-në.

Kjo përfshin koordinimin me drejtorinë e AIDA-s për të harmonizuar përpjekjet institucionale me objektivat më të gjera kombëtare.

Për më tepër, ne jemi të angazhuar në mënyrë aktive në zhvillimin dhe menaxhimin e agjendës për aktivitete të ndryshme, duke siguruar përafrimin e tyre me strategjitë dhe objektivat kryesore.

Si pjesë e nxitjes së bashkëpunimit, ne jemi përgjegjës për hartimin e Memorandumeve të Mirëkuptimit (MoU) dhe lehtësimin e nënshkrimit të tyre, si brenda dhe jashtë vendit. Kjo kërkon bashkëpunim të ngushtë me aktorët dhe institucionet përkatëse për të siguruar që termat dhe kushtet për të cilat është rënë dakord të reflektojnë qëllimet strategjike të përshkruara në strategjitë kombëtare dhe kornizat e negociatave të BE-së.

5.1 STRATEGJI

5.1.1.Strategjia Kombëtare për Migracionin

Në përshtatje me përpjekjet për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Migracion dhe Planit të Veprimit 2024-2023, AIDA ka luajtur një rol kyç si institucion lider në disa pika të planit të veprimit, të miratuara me VKM-në 400, datë 19.06.2019.

Aktivitetet e ndërmarrura në kuadër të strategjisë për migracion janë shprehur nëpërmjet këtyre veprimeve:

1. Pjesëmarrje aktive në një workshop mbi (GCM). Kjo ka pasuar me qëllim forcimin e njohurive dhe kapaciteteve të punonjësve të administratës në fushën e migracionit, si dhe të Grupit Ndërinstitucional të Punës.
2. Angazhimi në një workshop për vlerësimin e situatës aktuale dhe prioritetëve kryesore në fushën e migracionit në Shqipëri. Ky aktivitet ka qenë thelbësor për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit të Veprimit.
3. Pjesëmarrje në një workshop mbështetës për hartimin dhe zbatimin e Strategjisë së re Kombëtare për Migracionin (SKM) dhe Planit të Veprimit (PV) në Shqipëri. Qëllimi ka qenë përfundimi i draftit të SKM dhe PV 2024-2030, duke përfshirë kontributin paraprak të institucioneve qeveritare në fushën e migracionit.
4. Pjesëmarrje në një workshop mbi "Riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer në vend". Ky aktivitet ka analizuar situatën aktuale mbi shërbimet e riintegrimit në vend, masat strategjike dhe institucionale në këtë drejtim, dhe zbatueshmërinë e tyre në të ardhmen, duke u zhvilluar në kontekstin e Strategjisë së re Kombëtare për Migracionin dhe Planit të Veprimit.
5. Dhënie mendimi mbi Draft-Planin e Veprimit për Strategjinë Kombëtare për Migracionin 2024-2030, në të cilin AIDA ka luajtur një rol kryesor si institucion lider në zbatimin e masave.
6. Kontributi i AIDA-s në plotësimin e të dhënave në pasaportën e indikatorëve në vazhdim të punës për finalizimin e hartimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe Planit të Veprimit 2024-2026.

Këto veprime tregojnë një përkushtim të vazhdueshëm të AIDA-s në adresimin e sfidave të migracionit në Shqipëri dhe në krijimin e një strategjie të qëndrueshme dhe efikase për të përballuar këto çështje aktuale dhe të ardhshme.

5.1.2. Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023

Në kontekstin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit për periudhën 2019-2023 dhe Planit të Veprimit, AIDA shërben si institucion drejtues, bashkë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, në dy aspekte kyçe të planit të aprovuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 413, datë 19.6.2019.

Në përputhje me objektivat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) ka një rol të veçantë në përmbushjen e dy qëllimeve specifike: "Nxitja e investimeve strategjike private" dhe "Tërheqja e markave të njohura ndërkombëtare në sektorin e hotelarisë dhe turizmit".

Në vitin 2023, duke zbatuar Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 413, datë 19.06.2019, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023 dhe të Planit të Veprimit", AIDA ka raportuar rregullisht, në përputhje me kërkesat e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, lidhur me përmbushjen e objektivave të përcaktuara në kuadër të saj.

5.1.3. Draft Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit. (2024-2030)

Në kornizën e përgatitjes së Draft Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit (2024-2030), Drejtoria e Koordinimit ka pasuar një rrugëdrejtë strategjike, duke mbështetur dhe koordinuar me kujdes kontributin e AIDA-s në bashkëpunim të ngushtë me Horthway HTL, një konsulent të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për përgatitjen dhe formulimin e kësaj strategjie thelbësore.

Në përshtatje me hapat e vazhdueshëm të bashkëpunimit, u organizua dhe realizua një intervistë e veçantë me Drejtorin Ekzekutiv dhe ekspertët nga Horthway HTL. Dialogu i thelluar shtriu një vizion të qartë mbi rolin dhe kontributin e AIDA-s në draftin e Strategjisë së re.

Ky dokument përfshiu detaje thelbësore, duke adresuar vizionin e AIDA-s, planet strategjike dhe sfidat aktuale që organizata përjeton në fushën e turizmit. Në veçanti, u diskutuan karakteristikat unike dhe stimulimet që Shqipëria ofron në këtë sektor të ndjeshëm.

Përmes këtij bashkëpunimi të thellë dhe produktiv me Horthway HTL, u shpërndanë materiale informativë nga AIDA, duke përfshirë factsheet të përgatitura me kujdes për sektorin e Turizmit. Proces ndihmoi në përcaktimin e funksioneve dhe aktiviteteve të AIDA-s, duke përgatitur terrenin për një strategji integrale dhe të përmbushur për avancimin e zhvillimit të turizmit në vend.

5.1.4. Strategjia Ndërsektorale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023 -2025

Në Kuadër të Strategjisë Ndërsektorale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023-2025: Në përshtatje me detyrat dhe objektivat e përcaktuara në Strategjinë Ndërsektorale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023-2025, e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.81, datë 14.02.2023, AIDA ka përgatitur një raport të detajuar mbi kontributin e saj në këtë kontekst. Ky raport ofron një analizë të thelluar dhe një vlerësim të ndikimit të veprimtarisë së AIDA-s në përcjellje të synimeve strategjike të përcaktuara nga Ministria e Brendshme.

- Takimi me Qendrën e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në Kontekst të Strategjisë Ndërsektorale: Si një hap konkret në implementimin e Strategjisë Ndërsektorale, AIDA ka organizuar dhe realizuar një takim të rëndësishëm me Qendrën e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm. Ky takim ka shërbyer për koordinim të veprimit, shkëmbim të informacionit dhe përcaktim të strategjive të përbashkëta për parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm.
- Dërgimi i Ftesave për Pjesëmarrje në Trajnimin e AIDA në Bashkëpunim me GADC në Kontekst të Strategjisë Ndërsektorale: AIDA, duke ndjekur qëllimet e Strategjisë Ndërsektorale, ka dërguar ftesa për pjesëmarrje të personave subject të strategjisë në fjalë në trajnimin e saj në bashkëpunim me GADC.

5.2. KONTRIBUTI NË KUADËR TË BE- SHQIPËRI

Në përshtatje me objektivat e integritit në Bashkimin Evropian, AIDA ka dhënë një kontribut të vazhdueshëm në përafrimin e legjislacionit shqiptar me standardet dhe kriteret e Bashkimit Evropian. Për këtë qëllim, organizata ka përqendruar përpjekjet e saj kryesisht në Kapitullin "Kriteri Ekonomik" dhe Kapitullin 20 "Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale".

5.2.1. Kontribut për Kapitullin "Kriteri Ekonomik" dhe Kapitullin 20 "Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale"

Në periudhën e vlerësuar, AIDA ka zhvilluar një sërë aktivitetesh dhe raportimesh në këtë drejtim:

- Raportim për kontributin dhe materiale të Këshillit Shqiptar të Investimeve (KSA) për Kapitullin 20 dhe "Kriteri Ekonomik", duke përfshirë periudhën nga 1 mars 2022 deri në shkurt 2023.
- Dhënia e kontributit për Planifikimin e Kapitullit të Ndërmarrjeve dhe Politikave Industriale për vitin 2023, duke respektuar fushën e përgjegjësisë të caktuar nga Qeveria shqiptare.
- Përgatitja e një raporti të strukturuar për kontributin e AIDA-s për Kapitullin 20, sipas formatit të kërkuar nga shërbimet e Bashkimit Evropian.
- Pjesëmarrja në ushtrimet (Mocking Exercise 1 dhe 2) në përgatitje për takimin bilaterale, si dhe pjesëmarrja online në "BILATERAL MEETING WITH ALBANIA" në Bruksel mbi Kapitullin 20.
- Kontributi në monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Bashkimit Evropian për vitin 2023 në Kapitullin 20, si dhe pjesëmarrje në takimin e GNPIE për Kapitullin 20.
- Kontributi në hartimin e Planeve të Zhvillimit të Afërta Ekonomike (PKABE) 2024-2030 dhe Planeve të Kapitullit të Ndërmarrjeve dhe Politikave Industriale (PKIE) 2024-2026.
- Kontributi për kapitullin 20 në kontekstin e "Accelerated Integration" dhe përkushtimi në përmirësimin e raportimit për Progresin e Shqipërisë në Kapitullin 20.
- Kontributi në raportin e Progresit të Bashkimit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023, duke përfshirë periudhën qershor-shtator.
- Pjesëmarrje në takimin mbi rishikimin e dokumentit të Pozicionit Negociues për pjesën "Kriterin Ekonomik".

Këto veprime shënojnë një angazhim të vazhdueshëm të AIDA-s në procesin e përafrimit dhe integritetit me standardet evropiane në fushën e ekonomisë dhe ndërmarrjeve.

5.2.2. Kontribut për Nënkomitetin e "Çështjeve Ekonomike, Financiare dhe Statistikat"(Ecofin)

Në përshtatje me rolin e saj në kontekstin ndërkombëtar, AIDA ka dhënë një kontribut të vlefshëm në Nënkomitetin e "Çështjeve Ekonomike, Financiare dhe Statistikave" (Ecofin). Në këtë drejtim, AIDA ka pasuar një agjendë të ngjarjeve dhe aktiviteteve konkrete:

- Pjesëmarrja në takimin e 15-të të Nënkomitetit Ecofin, ku AIDA ka marrë pjesë online me datat 12-13 shtator 2023. Kjo pjesëmarrje ka pasuar një angazhim të fortë për të prezantuar dhe diskutuar kontributin e AIDA-s në fushën e çështjeve ekonomike, financiare dhe statistikave.
- Përditësimi i dokumentit të AIDA-s mbi "Çështjet Ekonomike, Financiare dhe Statistikat" (Ecofin). Ky dokument i përditësuar është një reflektim i zhvillimeve të fundit dhe kontributit të AIDA-s në këtë fushë. Ky proces i përditësimit shërben për të mbajtur informuar dhe të përgatitur për të ndarë njohuritë dhe përvojat e AIDA-s me pjesëmarrësit në arenën ndërkombëtare.

Ky angazhim aktiv në Ecofin shënon një pjesëmarrje të përkushtuar dhe vazhdueshme të AIDA-s në kuadër të Stabilizim Asocimit Bashkim Evropian- Shqipëri, duke siguruar një platformë për të ndihmuar në zhvillimin dhe përmirësimin e politikave dhe praktikave ekonomike dhe financiare në nivel kombëtar.

5.2.3. Kontribut për Economic Reform Program (ERP)

• Pjesëmarrje aktive në misionin e TAIEK, i mbajtur në datat 13-14 Shkurt 2023, për të raportuar kontributet e dorëzuara për Programin e Reformave Ekonomike (ERP) dhe për të pasuar rishikimin e tyre, veçanërisht nëse ka sygjerime nga ekspertët e Bashkimit Evropian.

Misioni u fokusua te ERP final dhe u diskutuan sfidat e identifikuar, reformat e propozuara, niveli i zbatimit të rekomandimeve (policy guidance) dhe çështje të tjera sipas pikave të axhendës.

• Përditësim i materialit të ERP për periudhën 2023-2025 në gjuhën shqipe dhe anglisht, duke u përshtatur me kërkesat dhe komentet e Bashkimit Evropian.

Kjo përpjekje ka për qëllim të sigurojë një dokument të plotë dhe të përditësuar në lidhje me kontributin e AIDA-s, duke përfshirë edhe rregullat dhe standardet e BE-së.

- Raportim i detajuar për delegacionin e Bashkimit Evropian në lidhje me dokumentin e ERP, duke përmbledhur informacionin relevant dhe ndikimin e AIDA-s në fushën e saj të përgjegjësisë. Kjo raportim ka si qëllim të sigurojë një transparencë të plotë dhe të adresojë çdo kërkesë ose pyetje të delegacionit të BE-së në lidhje me kontributin e AIDA-s në Programin e Reformave Ekonomike.

5.3. KOORDINIM INSTITUCIONAL

Në periudhën e fundit, Agjenca për Zhvillim dhe Investime në Shqipëri (AIDA) ka angazhuar një sërë të veprimtarive dhe bashkëpunimeve për të përmirësuar klimën e investimeve në vend. Në këtë kontekst, ka shfaqur një përkushtim të vazhdueshëm në përmirësimin e informacionit dhe ndërveprimin me aktorët ndërkombëtarë. Disa nga aktivitetet kryesore dhe kontributet e AIDA-s janë:

1. **Bashkëpunimi me Cincinnati University:**
 - Koordinimi i pritjes së përfaqësuesve të Cincinnati University.
 - Ndihma në njohjen e klimës së biznesit në Shqipëri dhe prezantimi i mundësive për investime.
2. **Marrëveshja për përfaqësim në tregun austriak:**
 - Koordinimi dhe bashkëpunimi për draftimin e marrëveshjes së përfaqësimit me Z.Gabriel Edhart për tregun austriak.
3. **Bashkëpunimi në evente të ndryshme:**
 - Koordinimi i sektoreve të AIDA-s për pjesëmarrje në eventin e konsullatës daneze mbi eksportet.
 - Organizimi i panelit Diasporta Shqiptare për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe pjesëmarrja aktive e AIDA-s në këtë ngjarje.
4. **Energy Week Western Balkan 2023:**
 - Pjesëmarrja në këtë ngjarje në bashkëpunim me FDI, me fokus kryesisht në sektorin e Energjisë së Rinovueshme.
 - Prezantimi i incentivave dhe potencialeve të Shqipërisë si destinacion atraktiv për investitorët ndërkombëtarë.
5. **Administrata dhe Koordinimi:**
 - Zhvillimi i Planit të Integritetit dhe koordinimi i përgatitjes së Planit për AIDA-n;
 - Përgatitja e Regjistrimit të Riskut;

- Koordinimi i përgatitjes së materialeve për mbledhjet e Këshillit të Investimeve;
 - Menaxhimi i informacionit përmes AIDA INFO të 194 kërkesave të ardhura për periudhën Tetor – Dhjetor 2024 dhe databazës së shkresave, duke përfshirë afatet për veprimtari të ndryshme;
 - Përditësimi dhe ruajtja e listës së kontakteve dhe databazës së insitucioneve të shtetit shqiptar, organizatave të huaja që operojnë në vend, Ambasadave Shqiptare në botë si dhe Ambasadat e huaja në Shqipëri, aktoreve të tjerë bashkëpunues në fushën e biznesit;
6. **Prezantime dhe Komunikim:**
 - Përgatitja dhe prezantimi i raporteve dhe materialeve për problematikat e AIDA-s.
 - Koordinimi i prezantimeve mbi funksionet e AIDA-s dhe zhvillimet në këtë fushë.
 7. **Menaxhimi i Ankesave dhe Bashkëqeverisja:**
 - Adresimi i çështjeve dhe ankesave nga media ndërkombëtare.
 - Adresim, koordinim dhe trajtim i 5 ankesave nga Platforma e Bashkëqeverisjes deleguar në adresë të AIDA-s.
 - Përpjekjet për përmirësimin e performancës së AIDA-s në përgjithësi.
 8. **Administrata dhe Planifikimi:**
 - Përgatitja dhe ruajtja e dosjeve për takimet e Drejtorit Ekzekutiv ku janë realizuar mbi 50 takime gjate vitit 2023;
 - Menaxhimi i mbi 15 kërkesave nga media të huaja;
 - Përgatitja e dokumentacionet mbi procedurat e Prokurimeve për vitin 2023.

Për këdo palë të interesuara, kjo përmbledhje ofron një vështrim të gjerë dhe të detajuar mbi kontributet dhe aktivitetet e fundit të AIDA-s për të përmirësuar klimën e investimeve dhe zhvillimit ekonomik në Shqipëri.

5.4. KOORDINIM NDËRINSTITUCIONAL

1. Në përpjekje për të ndihmuar në zhvillimin e investimeve në Shqipëri, kemi ruajtur kontakte aktive dhe të vazhdueshme me trupat diplomatike. Ne ofrojmë informacion të përditësuar në bazë të kërkesave të tyre për të ndihmuar në identifikimin e mundësive të investimeve në Shqipëri.

2. Për të koordinuar bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar, kemi përkujdesur për përgatitjen e dosjeve të nevojshme të bashkëpunimit. Kjo përfshin koordinimin e përgatitjes së dosjeve të kërkuara nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria për Evropës dhe Punët e Jashtme në kuadër të takimeve dhe bashkëpunimeve të ministrave.

3. Ne kemi vendosur ura të bashkëpunimit me Ministria e Investimeve në Arabi Saudite, duke vazhduar zbatimin e marreveshjes me MFE-në dhe duke komunikuar në mënyrë aktive me Ministrinë e Investimeve në Arabi Saudite.

4. Kemi dhënë një kontribut të rëndësishëm në hartimin e draft-marreveshjes së bashkëpunimit midis Agjencisë së Zhvillimit të Investimeve në Shqipëri (AIDA) dhe Dhomës Italiane-Çeke të Tregtisë dhe Industrisë duke përfshirë nënshkrimin e kësaj marreveshjeje.

5. Kemi organizuar një takim me Bankën Botërore për të diskutuar politikën dhe promovimin e investimeve në Ballkanin Perëndimor, duke krijuar një platformë për ndërkohë bashkëpunim.

6. Kemi koordinuar takimin me homologët tanë në Azerbajxhan (AZPROMO), duke eksploruar mundësitë për bashkëpunim të ardhshëm dhe duke krijuar një rrugë drejt bashkëpunimit potencial.

7. Në kuadër të promovimit të Shqipërisë në Bavarisë, Shoqata e Industrisë së Bavarisë (VBW) do të organizojë një konferencë biznesi në Mynih në datë 10 Prill 2024. Në fokus të konferencës do të jenë mundësitë që ofron Shqipëria për investime dhe bashkëpunime në sektorin e IT-se dhe Energjisë së Rinovueshme. AIDA është në komunikim të vazhdueshëm me përfaqësues të VBW mbi organizimin dhe pjesëmarrjen tonë në një prej paneleve të konferencës.

8. Përgatitja e kërkesës për dhënie të asistencës mbi realizimin e raporti të matjes së performancës së AIDA-s, në bashkëpunim me (GIZ) me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e veprimtarisë.

5.5. DELEGACIONE 2023

1. Ne kemi pritur me interes një delegacion nga Emiratet e Bashkuara Arabe, në krye me Z. Abudalla Nasser Lootah, Zëvendësministër i Çështjeve të Kabinetit për Konkurrencën dhe Shkëmbimin e Dijes.

Takim ka shërbyer për shkëmbimin e përvojës midis dy institucioneve dhe krijimin e një platforme të përbashkët për lehtësimin dhe tërheqjen e investimeve të huaja në Shqipëri.

Kemi pasuar një qasje aktive dhe të koordinuar për të siguruar suksesin e këtij takimi dhe për të vendosur një bazë të qëndrueshme për bashkëpunimin e ardhshëm.

2. Në përpjekje për të koordinuar me efikasitet, është zhvilluar një koordinim i brendshëm dhe me Agjencinë Polake të Investimeve dhe Tregtisë (PAIH) për organizimin e Tryezës së Rrumbullakët Poloni-Shqipëri. Pjesëmarrja jonë në këtë forum ka përfshirë koordinimin me të gjitha institucionet dhe bizneset pjesëmarrëse.

Forumi i Biznesit Polako-Shqiptar që ndodhi në Tiranë më 11 maj 2023 ishte një sukses i shkëlqyer. Organizuar nga PAIH dhe AIDA, ky takim siguroi një platformë shumë të rëndësishme për ndërtimin e lidhjeve dhe njohjen mes sipërmarrësve nga Polonia dhe Shqipëria. Në forum u zhvilluan takime intensive B2B dhe B2G midis sipërmarrësve shqiptarë dhe atyre polakë. Pjesë e delegacionit ishte edhe Presidenti Polak Duda si dhe nga pala shqiptare Presidenti. Z. Bajramaj.

Fokusi ishte në mundësitë e tregtisë bilaterale dhe prezantimet e kompanive në një atmosferë miqësore.

Forumi u përmyll me nënshkrimin e një marreveshjeje bashkëpunimi midis PAIH dhe AIDA duke përmyllur kështu një ngjarje të frytshme dhe perspektivë për bashkëpunim të ardhshëm.

Ky raund biznesi shënoi një hap pozitiv drejt intensifikimit të marrëdhënieve ekonomike midis Shqipërisë dhe Polonisë.

3. Një nga përkushtimet tona të fundit ka qenë organizimi dhe koordinimi i një eventi të rëndësishëm me një delegacion gjerman. Kemi koordinuar agjendën midis institucioneve pjesëmarrëse dhe delegacionit gjerman për të siguruar një realizim të përsosur të forumit. Kemi përgatitur dhe koordinuar agjendën me institucionet shqiptare dhe bizneset vendore, duke siguruar një shoqërim dhe pritje të përkushtuar për delegacionin gjerman gjatë qëndrimit të tyre në Shqipëri.

Shoqërimi dhe mbështetja jonë ka përfshirë gjithashtu koordinimin e takimeve të percaktuara në agendë për të siguruar një dialog të hapur dhe efektiv midis palëve pjesëmarrëse.

Aktiviteti ka qenë një përpjekje e përbashkët për koordinimin e agjendës midis institucioneve pjesëmarrëse dhe delegacionit gjerman "The Young Entrepreneurs / The Family Entrepreneurs" për realizimin e një forumi Shqipëri.

Fokusi ka qenë në disa sektore potenciale si sektori i teknologjisë informative (IT), zhvillimet e pasurive të patundshme dhe hoteleve në lidhje me turizmin, inovacionet dhe kultura e start-up në Shqipëri, si dhe bashkëpunimi i mundshëm në fushën e logjistikës.

Koordinimi i agjendës ka përfshirë një plan të strukturuar për organizimin dhe koordinimin e ngjarjes me institucionet dhe bizneset shqiptare. Pritja dhe shoqërimi i delegacionit gjerman gjatë qëndrimit në Shqipëri janë planifikuar për të siguruar një mbështetje të plotë për realizimin e takimeve të percaktuara në agendë.

Aktiviteti përfshiu disa elementë kyçe, përfshirë pritjen dhe organizimin e ngjarjeve si darka/receptions, takime politike me ministrat dhe kryeministrin, takime me Dhomën e Tregtisë, vizitë në 3 kompani vendase si dhe organizimin e nje Forumi Biznesi ku ishin te ftuar aktore nga bota e biznesit, politikës dhe qeverisë.

Forum pasoi me organizimin e nje sesioni B2B midis delegacionit "The Young Entrepreneurs" dhe bizneseve shqiptare te ftuar nga AIDA.

5.6. AKTIVITETE

- "Energy Week Western Balkan 2023" u ndoq me kujdes nga Agjencia për Investime të Zhvillimit të Shqipërisë (AIDA) si partneri zyrtar i shtetit, në bashkëpunim me organizatorët e ngjarjes. Aktiviteti u mbajt nga 18 deri më 19 tetor në Regent Porto Montenegro dhe ishte një platformë e rëndësishme për prezantimin dhe promovimin e mundësive të investimeve në sektorin e energjisë në Ballkanin Perëndimor. Si pjesë e këtij partneriteti, AIDA përfitoi nga një prezantim i lartë në ngjarje dhe një ekspozim maksimal, duke theksuar rolin e saj si kryeportë për investitorët e huaj në Shqipëri. Përveç kësaj, AIDA mori mbështetje nga organizatorët në organizimin e takimeve me investitorët e interesuar për projekte në Shqipëri. Në vijim, AIDA ka planifikuar të vazhdojë të ndjekë dhe të zhvillojë këtë bashkëpunim në të mirë të zhvillimit të sektorit të energjisë në vend. AIDA ka koordinuar me sukses pjesëmarrjen dhe angazhimin e institucioneve të tjera shqiptare që kanë lidhje me sektorin e energjisë në "Energy Week Eastern Balkan 2023".

Për këtë ngjarje, AIDA ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për të siguruar pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e efektshëm të autoriteteve dhe kompanive relevante në fushën e energjisë.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, ERE, OST si dhe përfaqësues të tjera të rëndësishëm të sektorit, AIDA ka siguruar një prezantim të përbashkët dhe të koordinuar .

Ky bashkëpunim i mirëstrukturuar ka ndihmuar në paraqitjen e një pamje të plotë dhe koordinuar të sektorit të energjisë shqiptare para investitorëve ndërkombëtarë.

- Trade Academy Trade Promotion është një trajnim që synon të ofrojë njohuri dhe kapacitete të nevojshme për të mbështetur kompanitë në rritjen e aftësive të tyre eksportuese. Organizohet nga Bordi Kombëtar i Tregtisë, agjencia qeveritare suedeze për tregtinë ndërkombëtare, tregun e brendshëm të BE-së dhe politikën tregtare. Akademia e Tregtisë Promovimi i Tregtisë ofron njohuri të vlefshme për promovimin e tregtisë dhe se si politika tregtare ndikon në të bërit biznes në vende të tjera. Pas përfundimit të kursit, pjesëmarrësit pritet të kenë fituar njohuri të zgjeruara mbi arenën e tregtisë globale dhe rolin e tregtisë në arritjen e Agjendës 2030, mjete për të punuar me sukses me promovimin e eksporteve dhe tregtimin me BE-në. Drejtorja e Koordinimit morri pjesë në këtë trajnim në Suedi nga data 15 Nëntor deri në datën 21 Nëntor 2023 sipas një agende të ngjeshur të organizuar dhe koordinuar nga Trade Academy Trade Promotion. Në përmbledhje, programi iu dha pjesëmarrësve me sukses një kuptim gjithëpërfshirës të dinamikës së tregtisë, nga politika dhe gjeopolitika te ushtrimet praktike dhe njohuritë e industrisë, duke nxitur një perspektivë gjithëpërfshirëse mbi këtë temë.

5.7. RAPORTIME

1. Gjenerimi dhe Koordinimi i Informacionit:

- Identifikimi dhe analiza e informacionit kyç për çdo sektor të AIDA-s.
- Bashkëpunimi dhe komunikimi i rregullt me përfaqësuesit e secilit sektor për të siguruar një përmbajtje të pasur dhe të përshtatshme.

2. Weekly Planner:

- Hartimi i një planifikimi javor për të koordinuar detyrat dhe takimet e rëndësishme.
- Monitorimi i zbatimit të planifikimit dhe përditësimi i nevojshëm nëse ndodhin ndryshime apo emergjenca.

3. Përgatitja e Raporteve Mujore për periudhën Janar-Dhjetor 2023:

- Mbledhja dhe organizimi i të dhënave mujore për secilin sektor.
- Hartimi i raporteve mujore duke përdorur një strukturë të qartë dhe të standardizuar.
- Sigurimi që raportet mujore të përmbajnë informacionin e nevojshëm për analizën e performancës dhe identifikimin e trendeve.

4. Përgatitja e Raportit Vjetor 2023:

- Kombinimi i të dhënave mujore për të krijuar një përshtatje vjetore të performancës dhe rezultateve.
- Shqyrtimi i sfidave dhe arritjeve kryesore të vitit për të pasqyruar në raportin vjetor.

5. Raportim për Matjen e Performancës dhe Rezultateve (KPI):

- Identifikimi i indikatorëve kryesore për matjen e performances për periudhën Janar – Qershor 2023 dhe Korrik- Dhjetor 2023.

6. Raportim Kontributi mbi Draft Gantt:

- Shqyrtimi i Draft Gantt dhe raportimi i progresit aktual.

7. Raporti i Sekretariatit të OBt dhe Raporti i Qeverisë në Kuadër të Trade Policy Review për Shqipërinë:

- Përditësimi i raporteve nga Sekretariati i OBt dhe Qeveria në lidhje me politikat tregtare për Shqipërinë.
- Identifikimi dhe përfshirja e çështjeve kyçe dhe rekomandimeve në raportin vjetor të AIDA-s.

8. Raportim mbi Kartën e Performancës nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë:

- Sigurimi i të dhënave të sakta dhe relevante për çdo element të Kartës së Performancës.
- Koordinimi dhe përgatitja e kontributit të AIDA-s në aspektet e caktuara nga Ministria.

6 DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Misioni i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse: mbështetja e veprimtarisë së Agjencisë, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, me qëllim krijimin e infrastrukturës dhe burimet e domosdoshme që garantojnë zhvillimin normal të proceseve të punës, si dhe të ndjekë të gjithë aktivitetin ekonomik - financiar dhe administrativ të Agjencisë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

6.1. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve (AIDA), gjatë vitit kalendarik 2023, në bazë të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Vendimit nr. 1, datë 25.03.2019 "Për një ndryshim në vendimin nr.2, datë 04.01.2011 "Për miratimin e statutit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve", ka ndër marrë procedurat e nevojshme për rekrutimin e stafit sipas vakancave të rezultuara.

Konkretisht gjatë këtij viti janë rekrutuar 12 (dymbëdhjetë) punonjës dhe janë larguar:

- Me dorëheqje 8 (tetë) punonjës;
- Me lirim nga detyra ka sa dal në pension 1 (një) punonjëse;

Ndërkohë ka patur 5 (pesë) transferime të brendshme, nga të cilat 2 (dy) kanë qenë lëvizje paralele dhe 3 (tre) ngritje në detyrë.

Gjithshtu me Vendimin e Bordit Drejtues të AIDA-s nr. 1, datë 14.09.2023, "Për lirim dhe emërimin në detyrë të Drejtorit Ekzekutiv të AIDA-s", është larguar nga detyra Drejtori Ekzekutiv z.Sokol Nano dhe në vend të tij është emëruar znj. Laura Plaku (Saro).

Theksojmë se gjatë këtij viti, AIDA, ndryshe nga viti 2022, nuk ka punësuar asnjë student ekselence në kuadër të nismës "Gati për Shqipëri" dhe nuk ka patur as punonjës me kontratë jashtë organikës.

Gjatë vitit 2023, punonjësit e AIDA-s kanë rritur kapacitetet dhe aftësitë duke marrë pjesë në trajnime me tematika si më poshtë:

- Rregullat e arkiv/protokollit;
- Përdorimi i sistemit AFMIS, (Thesari Tiranë);
- Arbitrazhi Ndërkombëtar i Investimeve (organizuar nga GIZ);
- Vlerësimi i sistemit të brendshëm nga Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme dhe raportimi në MFE, (organizuar nga ASPA);
- Marketing, Trade and Export Analyses, ITC;
- Marketing research, GIZ;

Në fund të vitit, DSHM, nëpërmjet pyetësorit për "Vlerësimin e Nevojave për Trajnim për vitin 2024", identifikoi fushat të cilësuar si prioritare për trajnim nga stafi i cili u angazhua në plotësimin e pyetësorit.

Rezultatet e këtij pyetësori u analizuan dhe u përcollën për njohje në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), duke kërkuar mbështetje për përfshirjen në programin e trajnimeve të saj për vitin 2024, të nevojave të rezultuara për AIDA-n.

6.2. Burimet e financimit gjatë vitit 2023

AIDA, në zbatim të Ligjit nr. 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.08.2008 "Për sistemin e menaxhimit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të udhëzimit nr.14, datë 30.05.2023 "Për Procedurat Standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore", si dhe ligjit nr.10303, datë 15.07.2010 "Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve"(AIDA), gjatë vitit 2023, ka administruar dhe menaxhuar fondet e vëna në dispozicion nga 2(dy) burime:

A. Buxheti i Shtetit në masën 155,570,000 lekë, ku përkatësisht 90,270,000 lekë për shpenzime korrente lidhur me objektin e veprimtarisë

së AIDA-s, konkretisht, promovimi i Shqipërisë si destinacion investimesh dhe shërbimet e kujdesit ndaj klientit dhe 65,300,000 lekë për shpenzime kapitale për investime me kapital të brendshëm dhe shpenzime kapitale për investime me kapital të jashtëm (projekti EEN).

Buxheti i mësipërm ka pësuar disa rishikime gjatë vitit 2023, si më poshtë:

- Shtuar në masën 410,000 lekë, për shpërblimin e disa prej punonjësve në zbatim të VKM me nr. 795 prot., datë 28.12.2023 “Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qendrore në procesin e shqyrtimit analitik të Acquis (Screening), në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian” dhe VKM me nr.834, datë 28.12.2023, “Për një ndryshim në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010, të këshillit të ministrave, “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar, dhe për shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023, miratuar për disa institucione”.
- Pakësuar në masën 57,000,000 lekë (artikulli 231 “Përmirësim sistemesh”), parashikuar për krijimin e regjistrit të Investimeve Publike në AIDA, (projekt i parashikuar për tu bërë në vitin 2022 dhe i papërfunduar), i cili nuk ka gjetur zbatim as gjatë këtij viti. Kjo devijancë ka ardhur si pasojë e nisjes të punës për draftimin e ligjit të ri për Investimet Strategjike dhe duke qenë se ky projekt kishte për qëllim krijimin e një regjistri për Investimet Strategjike (referuar VKM me nr. 1031, datë 16.12.2015 “Për përcaktimin e rregullave për funksionimin, krijimin, administrimin dhe për formatin, përmbajtjen e procedurat për sigurinë e regjistrit të investimeve strategjike”), AIDA pezulloj procesin e zhvillimit të këtij projekti. Më tej, gjatë muajit tetor 2023 nisën diskutimet me AKSH-in për zhvillimin e kësaj procedure, por si pasojë e afateve të ngushta për finalizimin e saj brenda vitit 2023, këto fonde u shpallën të lira nga ana jonë dhe me Aktin normative nr. 6, datë 14.12.2023, u bë reduktimi i plot i kësaj vlerë nga buxheti i AIDA-s.

- Pakësuar fondet e deklaruara të lira për artikullin 600 dhe 601, (pagat dhe kontributet e punonjësve të AIDA-s), konkretisht:

1. **Artikulli 600 është reduktuar në vlerën prej 9,020,000 lekë;**

2. **Artikulli 601 është reduktuar në vlerën prej 1,550,000 lekë.**

Reduktimi i fondeve të akorduara për këto dy artikuj, ka ardhur si pasojë e vendeve vakante të rezultuara gjatë kësaj periudhe në organikën e AIDA-s. Ky faktor ka ndikuar drejtpërdrejt në mosrealizimin e artikujve 600 dhe 601 të buxhetit, të akorduar për vitin 2023, si rrjedhojë fondet e mbetura të papërdorura janë deklaruar të lira dhe janë pakësuar nga buxheti i vitit 2023.

- Shtuar në masën 47,740 lekë artikulli 606, për dhënien e shpërblimit nga Fondi i Veçant për vitin 2023, për sa dal në pension një punonjës i AIDA-s.
- Pakësuar në masën 90,000 lekë artikulli 606 “Për Fondin e Veçantë” për AIDA-n për tu alokuar në favour të një institucioni tjetër pjesë i programit buxhetor “Mbështetje për zhvillim ekonomik”.
-

B. Organizata rajonale RCC (Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal), në masën 10,000 euro. Fondi në fjalë, (i konvertuar nga banka e nivelit të dytë në 1,151,000 lekë), u akordua për zhvillimin e fushatave për gjenerimin e leads së investitorëve nga AIDA, pjesë e angazhimeve të cituara në marrëveshjen e nënshkruar me RCC. Fondet e akorduara janë përdorur sipas kalendarit të aktiviteteve të dakordësuar midis RCC dhe AIDA-s, në masën 1,129,181 lekë, ose 98%.


Pjesë e këtyre aktiviteteve mund të përmendim si, prodhim materialesh promovuese me logon e RCC, pjesëmarrje në takime përfaqësuese jashtë vendit, promovim i RCC në revista ndërkombëtare online.

6.3 Zbatimi i buxhetit për vitin 2023

- Gjatë vitit 2023, fondet e AIDA-s të akorduara nga Buxheti i Shtetit, janë detajuar për shpenzimet korrente në artikujt 600, 601, 602 dhe 606, në funksion të përmbushjes së objektivave të institucionit. Ky buxhet është detajuar në fillim të vitit dhe më tej është rishikuar gjatë vitit për shkak të nevojave të lindura të përcjella nga njësitë e AIDA-s
- Gjatë vitit 2023, me ndryshimet e bëra në këtë buxhet, u realizuan shpenzimet korrente sipas grafikut të mëposhtëm.

Fondi për paga (artikulli 600) dhe sigurime (artikulli 601) u realizuan përkatësisht në masën 100% dhe 91%. Për sa i përket shpenzimeve korrente, ato u realizuan në masën 93%. Shpenzimet për transferta individësh u realizuan në masën 83%.

Më poshtë po ju paraqesim në formë grafike rezultatet e realizimit të buxhetit për vitin 2023.



6.4. Dokumenta ligjore prodhuar gjatë vitit 2023

Gjatë vitit 2023, DSHM, në kuadër të përmirësimit të akteve rregulluese për proceset e punës në AIDA, si dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi, ka punuar për hartimin dhe finalizimin e disa dokumentave si:

- Regjistri i riskut për AIDA-n**

Në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, me urdhër të Drejtorit Ekzekutiv është ngritur Ekipi për Menaxhimin e Riskut i përbërë nga drejtuesit e njësiteve të AIDA-s, të cilët punuan për hartimin e regjistrit të riskut në realizimin e objektivave të AIDA-s para dhe pas kontrollit.

- Plani i Integritetit për vitet 2023-2025 për AIDA-n**

Në zbatim të Vendimi të Këshillit të Ministrave nr.516, datë 1.7.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 247, datë 20.3.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit për periudhën 2015-2020 dhe Miratimin e Planit të Verpimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 e të Pasaportës së Indikatorëve" dhe Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr. 334, datë 7.10.2020 "Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të riskut të integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore", me urdhër të Drejtorit Ekzekutiv është ngritur Grupi i Punës i përbërë nga drejtuesit e njësiteve të AIDA-s, për hartimin e Planit të Integritetit 2023-2025 dhe planin e masave për AIDA-n. Materialet e finalizuara dhe të miratuara në parim nga MFE janë përcjellë tek kjo e fundit, si dhe është bërë publikimi i Planit të Integritetit dhe urdhrit të miratimit të tij në faqen zyrtare të AIDA-s.

- Udhëzimi "Mbi regjimin e qarkullimit, përpunimit dhe administrimit të dokumentacionit shkresor në Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve"**

Në zbatim të Ligjit nr.9154, datë 06.11.2023 "Për Arkivat", i ndryshuar dhe Normave Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë,

është hartuar dhe përcjellë për njohje/zbatim nga stafi i AIDA-s, Udhëzimi me nr. 95, datë 26.12.2023 “Mbi regjimin e qarkullimit, përpunimit dhe administrimit të dokumentacionit shkresor në Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”.

- **Rregullorja “Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe për deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike nga administrata e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”**

Në zbatim të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, është hartuar rregullorja “Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe për deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike nga administrata e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”, miratuar me urdhrin nr.101, datë 29.12.2023, të Drejtorit Ekzekutiv të AIDA-s, si dhe është bërë botimi i materialit në faqjen e internetit të AIDA-s.

ANEKS 1
PROJEKTE KONKRETE TË TRAJTUARA ME LIGJIN E INVESTIMEVE STRATEGJIKE

Nr.	Subjekti Aplikues/ Emri i Projektit	Sektori	Vlera/ Punësimi	Përshkrimi	Vendndodhja
1	MANE TCI "New Born" K22203004A	Turizëm	€ 26,000,000 250 vende pune	Kompleks turistik Vila dhe apartamente	Hamallaj, Durrës
2	GREEN COAST "Green Coast 1" L41329038D	Turizëm	€ 52,500,000 250 vende pune	Kompleks turistik Hotel me 100 dhoma 188 vila 136 apartamente	Palasë, Himarë
				Ndërtim i dy strukturave akomoduese turistike, hotel me 5 yje, si dhe kompleks turistik	
3	ALB PANEL NGR "Albpanel" L61605017K	Bujqësi Industriale	€ 15,000,000 300 vende pune	Projekti synon te përdorë lende te pare kallamin dhe te prodhojë si produkt final panele MDE	Libofshe (Fier) dhe Rremas, (Lushnjë)
4	AGROCON ALBANIA "Agrocon" L32406024O	Bujqësi	€ 5,832,000 120 vende pune	Ferme Bujqësore S=30 Ha	Ngurrëz e Vogël, Krutje, Lushnjë
5	CONCORD INVESTMENT "Gone Perivol" K81602049K	Turizëm	€ 32,500,000 200 vende pune	Kompleks Turistik Hoteleri dhe fshat turistik e ambiente shërbimi	Palasë, Himarë

6	CONCORD INVESTMENT "San Pietro" K81602049K	Turizëm	€ 88,000,000 250 vende pune	Kompleks Turistik Hoteleri me 5 yje, me 500 dhoma dhe fshat turistik e ambiente shërbimi	Gjiri Lalzit
7	BOIKEN SHPK "Kepi Merli" (Shënediella) K11718001R	Turizëm	€ 78,000,000 263 vende pune	Kompleks turistik Hotel me 5 yje me 210 njësi Hotel me 4 yje me 210 njësi 63 vila të llojeve të ndryshme Shërbime të tjera	Ksamil, Sarandë
8	"Dhërmi Resort" (Gaz Paja) "Startek" sh.p.k. L22327007K "Ecotech Energy Services" L61619030P	Turizëm	€ 12,140,000 300 vende pune	Kompleks turistik Hotel me 200 dhoma Kompleks vilash	Dhërmi
9	"Gas Power Plant"Korça" GPP KORÇA L73724004N" (investitor i huaj)	Energji (TEC Korça)	€ 349,700,000 123 vende pune	HEC KORÇA	Korçë
10	EUROCOL "White Rocks" J61810018B	Turizëm	€ 6,800,000 81 vende pune	Resort Turistik	Dhërmi Sip. 1.91 Ha
11	AQUATIQ SHPK Akuaponi – hidroponi L71320011G	Bujqësi	€ 5,1 mln 50 vende pune	Akuaponi – hidroponi	Karavasta, Divjakë Sip. 1.3 Ha Kërkon 146 Ha

12	"Agro Iliria Group" "Planatacion shege, avokado, finger lime" L51320033L	Bujqësi	€ 6,627 mln 115 vende pune	Planatacion shege, avokado, finger lime	Karavasta, Divjakë Sip. 500 Ha
13	YURA COPERATION ALBANIA "Fabrikë për prodhimin e sistemeve dhe pjesëve elektrike për automobilë" L81717032D (Investitor i Huaj)	Industri Automotive (Zonë me përparësi zhvillimi)	€ 6.459.000	Fabrike për prodhimin e pjesëve automotive	Baza e Tubove, Fier
14	SOLEIL & SEA shpk "Jala Entertainment Park "	Turizëm	€ 67,000,000 620 vende pune	Resort Turistik	Jalë - Vuno, Himarë
15	"TEDA TIRANË" BASHKIA TIRANË	Zonë e Teknologjisë dhe Zhvillimit		Realizimi i një Zone të Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik	Yzberisht, Gropaj dhe Kashar, Tiranë
			€ 62,000,000 5000 - 7000 vende pune	Realizimi i një Zone të Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik me qëllim tërheqjen e investimeve të huaja dhe teknologjive të reja dhe teknologjive të informacionit, hapjen e vendeve të reja të punës, nxitjen e zhvillimit ekonomik të qytetit të Tiranës duke fatur industri qëpërmbushin standarde ndërkombëtare me produktivitet të lartë.	Yzberisht, Gropaj dhe Kashar, Tiranë

16	LAJTHIZA INVEST SH.A "Kompleks Turizëm Rural Lajthiza" J98009202P	Turizëm	€ 20,000,000 200 vende pune	Hotel modern, si dhe një fabrikë të re të ambalazhimit të ujit të pijshëm në shishe.	Fshati Lajthizë, Bashkia Fushë – Arrëz
17	"TIRANA CITY CENTER" "Shiddi Group" sh.p.k. L92202023J "Al- Shiddi trading company" LTD 1010235319 (Investitor i Huaj)	Turizëm	106,850,000 1500 vende pune	Ndërtimi i një investimi kompleks dhe i përket pjesërisht sektorit strategjik të turizmit me strukturë akomoduese elitare Sky Village, strukturë mbështetëse turistike-qendër tregtare dhe garazh nëntokësor ashtu si dhe ndërtesë për zyra.	Tiranë
18	"Parku me erë" "Biopower Green Energy" sh.p.k. K72405024M "Marseglia Group" SRL CF00695260604 (Investitor i Huaj)	Energji	€ 244,000,000 350 vende pune	Ndërtimi i dy parqeve me erë, të quajtura BPGE1 dhe BPGE2, në kreshtat e dy maleve në Bashkinë e Lezhës, të cilat do të jenë të afta të gjenerojnë 234 MW dhe do të zhvillohet në një sipërfaqe prej 100 HA, në vargmalet e Rencit dhe Kakariqit, të vendosura paralel me vijën bregdetare në Shëngjin dhe Balldren, Lezhë.	Bashkia Lezhë
19	ILIR TREBICKA "Hotel Chaonians Deluxe" L81413013O	Turizëm	€ 5,500,000 90 vende pune	Ndërtim i një hoteli me 4 yje, si pjesë e kompleksit turistik të quajtur "Thymus", i cili shtrihet në një sipërfaqe totale prej 0.33 ha, të ndodhur në zonën kadastrale 1739, në fshatin Dhërmi, Himarë.	Bashkia Himarë

20	COAST TO COAST SH.P.K. GJIKURIA SH.P.K. K97117201D	Turizëm	€ 56,910,000 150 vende pune	Investimi kompleks i përbërë nga 3 hotele dhe vila rezidenciale me sipërfaqe truall 20.9 ha në zonën kadastrale 1739, në fshatin Gajtانيتika dhe Perivolo, Himarë.	Bashkia Himarë
21	GREEN COAST SH.P.K. "Green Coast 2" L41329038D	Turizëm	€ 60,800,000 720 vende pune	Green Coast 2: Ndërtimi i 5 hoteleve me 100 dhoma secili, vila individuale elitë, apartamente, pishina, restorante, bar-kafe, qendër shëndetësore, palestër dhe një park publik.	Bashkia Himarë
22	JONIAN HEAVEN GROUP SH.P.K. "Jonaian Heaven" L91404041V (Investitor i Huaj)	Turizëm	€ 78,365,976 819 vende pune	Projekti konsiston në ndërtimin e një kompleksi turistik, me 636 ambinete akomodimi restorante, bare, një kazino, salla konferencash, pishinë, SPA etj.	Bashkia Konispol
23	"MARINA DI VALONA" (JV) "Marina di Valona" shpk M01324008A	Turizëm	€ 105,000,000 1000 vende pune	Projekt i integruar i cili konsiston në zhvillimin e një infrastrukture koncensionare portuale turistike si dhe zhvillimin e njësisve akomoduese, hoteleri e shërbime të standardizuara të zonës në kufi me infrastrukturën portuale.	Bashkia Vlorë
24	AG.TCC SH.P.K. Tan Gaci "Dreamades Luxury Suites" L52227046H	Turizëm	€ 5,556,192 120 vende pune	Projekti parashikon realizimin e zhvillimit të një investimi kompleks, të përbërë nga një Hotel me 5*, i nivelit të lartë, i konceptuar në disa kate me tarraca dhe do të ketë një kapacitet prej 106 suita.	Bashkia Himarë

25	DAST SH.A. "Banyan Tree Hotel Resort" Luan Muca K81401501G	Turizëm	€ 24,184,990 184 vende pune	Resort me disa kate me taraca me kapacitet 184 dhoma (standarde, dupleks, suita dhe vila) si dhe do të ofrojë restorante, bare, pishina, SPA, palestër, salla konferencash, zona të dedikuara për fëmijët, parking dhe shumë mjedise të tjera çlodhëse e rekreative që do të plotësojnë të gjitha standardet në fuqi për certifikimin si "Hotel me 5 yje.	Bashkia Himarë
26	"AQUATIQ" SH.P.K. "Fermë akuaponi" L71320011G (Investitor i Huaj)	Bujqësi	€ 26,000,000 1500 vende pune	Projekti parashikon ndërtimin e një Ferme Akuaponike, me një sistem me dy nivele: • një rezervuar me peshq, si bazament i impiantit; dhe • sera ku do të rriten perimet mbi të.	Bashkia Divjakë
27	BLUE BAY SH.P.K. "Drymades Beach Resort" L92222038S	Turizëm	€ 6,326,000 165 vende pune	Projekti parashikon ndërtimin e 1 hoteli elitare të standardit 5 yje me 110 hapësira akomoduese.	Bashkia Himarë
28	PREMIUM FINANCE INVEST SH.P.K. "Cape of Rodon, Faza 1" L61711009G (Investitor i Huaj)	Turizëm	€ 51,369.455 200 vende pune	Projekti parashikon realizimin e një projekti kompleks. Faza e parë do të përfshijë realizimin e: • një hoteli me 4* me sipërfaqe 26,150 m2 do të ketë 250 dhoma si dhe shërbime në funksion të tij; • 30 vila me sipërfaqe totale prej 16,200 m2;; • një kantinë vere me sipërfaqe prej 2,000 m2; • një park ujor me sipërfaqe 500m2 me një kapacitet prej 500 personash.	Bashkia Durrës

29	DELTA SH.A. "Delta Falaise Resort & Village Faza 2,3,4,5" Luan Muca DELTA SH.A K13127202Ë	Turizëm	€ 154,964,433 200 vende pune	Faza 2, 3, 4, 5 parashikon ndërtimin e vilave individuale rezidenciale, 1 hotel me 5* dhe 245 dhoma, Vila rezidenciale, apartamente, njësi shërbimi, ambiente rekreative.	Bashkia Himarë
30	IMPERIAL GROUP SH.P.K. "Silver Sand Resort" L02424005D	Turizëm	€ 52,000,000 80 vende pune	Projekti parashikon realizimin e një kompleksi turistik. 2 Hotele me 5* 23 vila te tipologjive te ndryshme 204 apartamente	Bashkia Shkodër
31	"Manastir Resort - resort turistik 2, 3 dhe 4 kate me parkime nëntokë" "Alb Star" sh.p.k. J62903512Ë	Turizëm	€ 28,000,000 180 vende pune	Projekti parashikon ndërtimin e një resorti, që do të ketë në përbërje 1 hotel dhe struktura akomoduese me rreth 33 njësi të ndara me kapacitet total që variojnë nga 83-100 shtretër, restorant, bar, pishinë e jashtme etj	Bashkia Sarandë
32	"WHITE ROADS HOTEL" SH.P.K. "White Roads Hotel" M02407023J	Turizëm	€ 10.000.000 100 vende pune	Projekti parashikon ndërtimin e strukturave akomoduese (hoteli me 5 yje), me shumëllojshmëri ambjentesh pushimi dhe akomodimi në dispozicion të pushuesve.	Bashkia Himarë
33	MEDITERRANEAN WAVE SH.P.K. "Mediterranean Wave" M11916014A	Turizëm	€ 50,409,836 80 vende pune	Projekti parashikon ndërtimin e një Kompleksi Turistik. Struktura akomoduese do të ketë rreth 250 njësi (përfshi vila hotelerie, studio, apartament hotel), 170 dhoma dhe suita hoteli.	Bashkia Kavajë

34	"Marina & Jahtet e Durrësit" "EAGLE HILLS REAL ESTATE DEVELOPMENT (EHRED)" SHPK ME NUIS M11726006H (Investitor i Huaj)	Turizëm Infrastrukturë	€ 2,000,000,000 12,000 vende pune	Projekti i integruar me port turistik dhe struktura akomoduese elitare, rezidenca me standard të lartë dhe shërbime në funksion të tyre.	Bashkia Durrës
35	"FINSEC DEVELOPMENT" SH.P.K, "MARINA HILLS" M02219014S. (Investitor i Huaj)	Turizëm	€ 450,000,000 200 vende pune	Kompleks turistik	Bashkia Kavajë
36	"Resort turistik me vendndodhje në Gjirin e Lalëzit" "Omnix Albania" shpk K81527005D (Investitor i Huaj)	Turizëm	€ 216,000,000 252 vende pune	Resort me struktura akomoduese me një sërë funksionesh.	Bashkia Durrës
37	"Zagroturizëm" shpk L81829001O "Zagroturizëm"	Agro-turizëm	€ 5,457,335	Investim në fushën e hotelierisë dhe mikpritjes duke ofruar shërbime mikse në fushën e agroturizmit dhe turizmit malor me standarde të larta shërbimi për klientët.	Bashkia Tepelenë
38	Green House Korça Resort	Turizëm	18 mln EURO	Hotel me 5 yje dhe 94 dhoma.	Bashkia Korçë
39	Eralb Invest 2 shpk (Investitor i Huaj)	Energji	1.2 miliard EURO	Park me Erë dhe park Fotovoltaik	Bashkia Tropojë
40	The Cliffs of Tirana Adriatic Resorts LLC sha (Investitor i Huaj)	Turizëm dhe kazino	197 mln EURO	Hotel me 5 yje me 250 dhoma dhe 60 njesi apartamentesh; Kazino	Bashkia Tiranë

PROJEKTE INVESTIMI TË MOS PRANUARA

1	ADRIATICA HOLDING SHPK "Kultivimi i karakalecave" L71313025K	Bujqësi / akuakulturë	€ 4,200,000 120 vende pune	"Ferme për prodhimin e karkalecit të detit të llojit 'Penaeus Monodon (Giant Tiger Praën)	Bashkia Divjakë
2	SOUTH COAST DEVELOPMENT "Krorëz Resort" L71626018J	Turizëm	€ 110,000,000 600 vende pune.	Turizëm Hotel + Vila	Bashkia Himarë
3	"NOVOSELE PHOTOVOLTAIC POWER PLANT" L61709021P "Impiant Fotovoltaik Energjitik 50 MWAC	Energji	€ 84.782.706 Punësimi 503-784 vende	Impiant gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike	Bashkia Vlorë
4	"Mane TCI" SH.P.K. K22203004A "Vala Mare II"	Turizëm	€ 64,162,910 200 vende pune	Struktura turistike, vila dhe apartamente	Bashkia Durrës
5	"CONCORD INVESTMENT" SH.P.K. K81602049K "Saranda Marina Resort & Senior Housing"	Turizëm	€ 26,125,000 -	Kompleks turistik	Bashkia Sarandë
6	"MILLENIUM INTERNATIONAL" SH.P.K. L41411035H "Poro Vlorë"	Turizëm	€ 21,081,700 148 vende pune	Kompleks turistik	Bashkia Vlorë

7	"MABETEX GROUP" SH.P.K. "Divjaka Resort Albania"	Turizëm	€ 954,700,000 4900 vende pune	Resort turistik	Bashkia Divjakë
8	"ADRIATICA HOLDING" SHPK "Kultivimi i karakalecave të detit në Karavasta, Divjakë, zk.nr.2085"	Bujqësi / akuakulturë	€ 4,000,000 120 vende pune	Kultivimi i karkalecave	Bashkia Divjakë
9	"VORTEK" SH.P.K & "BEST DUTY FREE" SH.P.K. "Beryl Resort" K117080040	Turizëm	€ 15.519.970 165 vende pune	Resort turistik	Fshati Qerret, Bashkia Kavajë
10	"JONIAN HEAVEN GROUP" SH.P.K. "Jonian Heaven"	Turizëm	€ 78,000,000 443 vende pune	Dy hotele respektivisht, me 280 dhoma dhe 84 dhoma, restorante, bare, një kazino, salla konferencash.	Fshati Vrinë, Bashkia Konispol
11	"VORTEK" SH.P.K. & "BEST DUTY FREE" SH.P.K. "Beryl Resort"	Turizëm	€ 15.519.970 165 vende pune	Resort turistik	Bashkia Kavajë
12	"FAFA RESORT" SHPK	Turizëm	63,126,676 Euro 550 vende pune	Resort turistik, me një hotel me njëmbëdhjetë kate, katër godina apartamentesh dhe pesë vila individuale me një kapacitet total prej 519 dhomash	Fshati Qerret, Bashkia Kavajë
13	"PËR NDËRTIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E ZONËS SË TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK	Energji	€ 30,000,000	TEDA DURRES	Bashkia Durrës

	(TEDA) SPITALLË DHE INSTALIMIN E PARKUT FOTOVOLTAIK ME FUQI 40.54 MËP, DURRËS” “NOA ENERGY TRADE” SHPK, ME L42203031A				
14	“IMPIANTI AGRIVOLTAIK 120 MW” “NATYRE ENERGY” SHPK, ME NUIS: L72220033M”	Energji	€ 109,483,772	Impiant fotovoltaik	Bashkia Lushnje
15	“SOLAR ENERGY CELLS 300 MWP” SOLAR ENERGY CELLS SHPK, ME NUIS/NIPT: M26422204I	Energji	€ 175, 944,000	Park fotovoltaik	Bashkia Vlorë
16	“IMPIANT FOTOVOLTAIK ME FUQI 70MWP”, DH SOLAR PARK, ME NUIS/NIPT: M21809033P”	Energji	€ 31,000,000	Park fotovoltaik	Bashkia Pogradec
17	“IMPIANT FOTOVOLTAIK 150 MWP (AC) AGA SOLAR PARK” “AGA SOLAR” SHPK, ME NUIS/NIPT: M11415029E	Energji	€ 176,479,000	Park fotovoltaik	Fshati Darëzezë e Re, Bashkia Fier
18	“EURON SOLAR PV – 50 MW” “EURON” SHPK, ME NUIS/NIPT: J71317002N”	Energji	€ 37,500,000	Park fotovoltaik	Bashkia Fier

19	<p>“BELSHI SOLAR PARK” “VERBUND GREEN POWER ALBANIA” sh.p.k., ME NUIS/NIPT: M21423032T</p>	Energji	€ 60,000,000	Park fotovoltai	Bashkia Belsh
20	<p>“PARKU AGRIVOLTAIK FIER 170 MWP” “FIER HELIOS SHPK” ME NUIS/NIPT M22325031U</p>	Energji	€ 150,000,000	Park fotovoltai	Bashkia Fier
21	<p>“HELIOS GREEN ENERGY” HELIOS GREEN ENERGY SHPK, ME NUIS/NIPT: M26423202U</p>	Energji	€ 66,024,000	Park fotovoltai	Bashkia Selenicë
22	<p>PËR ANULIMIN E VENDIMIT TË KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE NR. 2/7, DATË 27.07.2020 DHE VENDIMIT TË KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE NR. 2/10, DATË 04.02.202</p> <p>Al Shiddi Trading Company LTD</p> <p>Shiddi Group sh.p.k, NUIS/ NIPT L92202023J</p>	Turizëm	€ 106,850,000	Strukturë turistike akomoduese	Bashkia Tiranë